



KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 29, Qershor 2011



Parlamenti Evropian - Kosova



Përmbajtja

Një grua Presidente e Republikës së Kosovës.....	3
Diplomacia Parlamentare në veprimtari intensive.....	5
Bruksel.....	6
Prishtinë.....	11
Deklarata e takimit të katërt Parlamenti Evropian -Kosovë.....	15
Holand.....	16
Itali.....	20
Tri pyetje për kryetarët e grupeve parlamentare.....	25
U mbajt tryeza për Strategjinë Legjislative 2011 N D I.....	27
Komisioni për punë të Jashtme inicicion.....	29
Krijohet Komisioni për Ndryshime Kushtetuese.....	30
OSBE-ja i dhuroi një fond librash Bibliotekës së Kuvendit të Kosovës.....	31
Takimet e Kryetarit.....	32



Kryeparlamentari Krasniqi në pervjetorin e 10-te te
Universitetit Pjeterbudi

E boton: Zyra për Media dhe Marrëdhënie më Publikun
Redaktoi: Petrit Subashi, Zyrtar i Lartë për Publikime

NJË GRUA PRESIDENTE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Presidentja Jahjaga në momentin e betimit

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese se zgjedhja e Presidentit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt ka qenë antikushtetuese, sot në një mbledhje të jashtëzakonshme, Kuvendi i Kosovës përsëri procedoi zgjedhjen e Presidentit.

Në hapje të punimeve, kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, i njoftoi deputetët se sipas nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës, dhe nenit 27 të Rregullosës së Punës së Kuvendit mund të procedohet me rendin e ditës. Ai në vijim njoftoi se janë mbledhur 41 nënshkrime nga deputetët për të nominuarën për Presidente, znj. Atifete Jahjaga, përkatësisht 31 për kundërkandidaten, znj.

Suzan Novobërdaliu.

Propozimin e të nominuarave për Presidente, e bëri Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentarë të PDK-së. Më pas, kreu i kuvendit i propozoi anëtarët e Komisionit për Mandate Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit. Ky Komision, në përbërje të: Arment Zemaj (LDK), kryetar i këtij Komisioni, Behar Selimi (PDK), zv.kryetar dhe anëtarët: Albulena Haxhiu (VV), Ardian Gjini (AAK), Ibrahim Makolli (AKR), Jasmina Zhivkoviç (SLS) dhe Mufera Shinik (Gjashtë Plus), u votuan unanimisht nga deputetët. Më pas, kryetarët e Grupeve Parlamentare bënë deklaratimet në emër të grupeve që përfaqësonin.

Me këtë rast, në emër të GP të PDK-së, Adem Grabovci tha se kemi përzgjedhur dhe përkrahim kandidaturën e znj. Atifete Jahjaga, si rezultat i marrëveshjes së tre liderëve, kryetarit të PDK-së, z. Hashim Thaçi, kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa dhe kryetarit të koalicionit Aleanca për Kosuva e Re, z. Behgjet Pacolli. Zgjedhja e znj. Atifete Jahjaga si kandidatë për Presidente është një përzgjedhje me një marrëveshje të gjerë konsensuale.

Në emër të GP të LDK-së, mbështetjen për të nominuarën Jahjaga, e deklaroi Vjosa Osmani, në emër të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të SLS-

së, Jasmina Zhivkoviç dhe në emër të Grupit Parlamentar Gjashtë Plus, Mufera Shinik.

VV:- Duke konsideruar se kandidatja Atifete Jahjaga, nuk është mishërim i vullnetit të popullit, Visar Ymeri (VV), tha se nuk e përkrahin kandidaturën e saj për Presidente dhe deklaroi se gjatë votimit do të lëshojnë sallën.

AAK:- Ardian Gjini në emër të AAK-së, deklaroi se gjatë votimit do të qëndrojnë në sallë duke mos u deklaruar për përkrahje.

Përkrahje për të nominuarën Jahjaga, deklaruan edhe përfaqësuesit e SLS-së dhe ata të grupit Gjashtë Plus.



Fjala e Presidentes Jahjaga para deputetëve

Pas këtyre deklarimeve, deputetët filluan votimin e rëndësishëm të parë, me ç'rast Komisioni konstatoi këtë rezultat: 80 vota për kandidaten Atifete Jahjaga, 10 vota për kandidaten Suzan Novobërdaliu dhe 10 vota u cilësuan të pavlefshme. Sipas këtij rezultati, znj. Atifete Jahjaga, në raundin e parë të votimit u zgjodh Presidente e Republikës së Kosovës, e cila menjëherë pas kësaj dha betimin para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Presidentja e posa zgjedhur iu drejtua deputetëve, e cila në mes tjerash nënvizoi: "Zgjedhja ime shpreh qëndrimin konsensual të partive politike për kapërcimin e krizës politike në vend". Ajo tutje tha se asnjëherë në jetën e saj nuk ka menduar

për një pozitë të tillë, por tha se gjithë herë ka qenë e gatshme t'i shërbejë vendit.

Duke folur për të ardhmen e vendit dhe rolin e saj si Presidente, ajo u shpreh se ka vullnet dhe besim se do të ndodhin ndryshime pozitive. Presidentja Jahjaga, në vijim tha se do të jetë në mbrojtje të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

Në mbledhjen e sotme deputetët miratuan edhe një Rezolutë në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes në mes të z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe të kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, të nënshkruar dje.

DIPLOMACIA PARLAMENTARE NË VEPRIMTARI INTENSIVE



Parlamenti Evropian dhe simbolet e tij

Pas një periudhe të gjatë ndërpreje të aktivitetit të vet Kuvendi i Republikës së Kosovës hyn rrjedhen e punës së vet. Diplomacia Parlamentare e Republikës së Kosovës ka patur një veprimtari mjaft intensive në periudhën e pare tre mujore. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, përveç takimeve diplomatike brenda Kosovës ka zhvilluar një sërë vizitash zyrtare me rëndësi, në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vet Parlamentin Evropian.

Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, liberalizimi i vizave për Kosovën, shtimin e njohjeve për Kosovën, embrojtja e dinjitetshme e moralit të luftës çlirimtare të Kosovës, zhvillimi ekonomik, ndërtimi i shtetit ligjor, vendosja e normalitetit në veri të Kosovës dhe vijimi i mëtejshëm i bisedimeve Kosovë – Serbi ka qenë edhe tematikat kryesore të axhendës diplomatike të Kryetarit të Kuvendit z. Jakup Krasniqi.

Vizita zyrtare në Bruksel kishte një agjentë mjaft të ngjeshur takimesh. Kryeparlamentari Krasniqi ka zhvilluar takime me zyrtarë të lartë të Parlamentit Evropian (PE) dhe të Senatit belg. Ai ka marrë pjesë në takimin e përbashkët parlamentar të organizuar nga PE-ja dhe Kuvendi Kombëtar i Hungarisë, me temën “Ballkani Perëndimor – drejt një Evrope

më të integruar”, si dhe në takimin me Grupin e Punës të Takimit të Përbashkët Parlamentar në Bruksel me temën: “Bashkëpunimi në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë”, në të cilat kryeparlamentari Krasniqi ka mbajtur fjalën.

Kryetari Krasniqi ka zhvilluar takime me personalitet e Parlamentit Evropian, kryetarin e Parlamentit Evropian, z. Jerzy Buzek, eurodeputeten znj. Doris Pak, anëtarin e Parlamentit Europian z. Eduart Kukan, me kryetarin e Parlamentit të Belgjikës, z. Andre Flahaut dhe zëvendëskryetaren e Senatit belg, znj. Helga Stevens, të cilët i ka njoftuar me gjendjen dhe të arriturat në Kosovë

Menjëherë pas kthimit nga Brukseli, Kryeparlamentari Krasniqi, nga 20-24 Prill i drejtohet Mbretërisë së Holandës për një vizitë zyrtare, ku është takuar me përfaqësuesit kryesor të Holandës.

Pas kthimit nga Holanda, për dy ditë rresht në Kuvendin e Kosovës, mbahet takimi i 4-t ndërparlamentar, Parlamenti Evropian – Kosovë.

Fill pas përfundimit me sukse të plotë të takimit të 4-t, Parlamenti Evropian - Kosovë, Kryetari i Kuvendit të Kosovës Dr. Jakup Krasniqi, zhvillon një tjetër vizitë zyrtare katër ditore në Republikën e Italisë.



Busek: PE mbështet pavarësinë, demokracinë dhe ekonominë e lirë të Kosovës



Kryetari i PE-së, z. Jarzy Busek, tha se Parlamenti Evropian është gati të mbështesë pavarësinë, demokracinë dhe ekonominë e lirë të Kosovës”. Ai vuri theksin në dy aspekte të veprimeve që duhet të ndërmerret Kosova: reformat e gjithanshme dhe bashkëpunimin në rajon.

Duke folur për zgjedhjet e fundit në Kosovë, ai shprehu një shqetësim për parregullsitë që janë shënuar në këto zgjedhje dhe kërkoi që zgjedhjet, në të ardhmen, të jenë të drejta dhe transparente. Delegacioni Evropian dhe z. Kukan, janë shumë të angazhuar që ta ndihmojnë Kosovën, por siç tha ai: - “Ju në Kosovë do të duhej të intensifikoni veprimet për realizimin e reformave në dobi të prosperitetit të Kosovës në të ardhmen. Përveç dialogut që po zhvillohet me Serbinë, është mirë që Kosova të ndërmerret edhe hapa të tjerë të bashkëpunimit me fqinjët dhe me Serbinë”.

Kryetari i Parlamentit Evropian shprehu kënaqësinë që, megjithë problematikën e vet, procesi për zgjedhjen e institucioneve në Kosovë, duke përfshirë edhe atë të presidentit të fundit, përfundoi suksesshëm.

Kryetari Krasniqi, e falënderoi z. Busek për ftesën që i ka bërë Parlamenti Evropian dhe ai i Hungarisë, për pjesëmarrje në takimin e përbashkët të PE-së me përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kreu i Kuvendit i shprehu mirënjohje Parlamentit Evropian për ndihmën që i ka dhënë Kosovës dhe në mënyrë të veçantë, Kuvendit, si dhe e falënderoi për trajtimin korrekt që PE-ja po i bën Kosovës dhe që ka një qëndrim më të avancuar nga institucionet e tjera evropiane. Krasniqi kërkoi që edhe ato ta trajtojnë kështu Kosovën dhe ajo të jetë e përfaqësuar

në të gjitha takimet multilaterale të rajonit.

Krasniqi u shpreh dakord me vërejtjet për parregullsitë që janë evidentuar gjatë zgjedhjeve, por theksoi se ato parregullsi, megjithatë, janë korrigjuar nga institucionet e pavarura dhe premtoi që në të ardhmen Kosova do të bëjë reforma të legjislacionit zgjedhor dhe nuk do të përsëriten lëshime dhe parregullsi të tilla.

Kreu i Kuvendit të Kosovës e njoftoi atë për konsolidimin institucioneve në Kosovë, për stabilitetin dhe sigurinë, për njohjet ndërkombëtare që i janë bërë Kosovës, për mbrojtjen e komuniteteve dhe të drejtave të njeriut. Ai vuri theksin në mënyrë të veçantë te problemet në veri të Kosovës, ku, siç tha Krasniqi, krimi i organizuar mbështetet nga strukturat e shtetit serb.

“Gjendja në veriun e Kosovës është në dëm edhe të vet serbëve që jetojnë atje”, theksoi Krasniqi, duke shtuar se institucionet e Kosovës po bëjnë përpjekje për integrimin e komunitetit serb dhe ka arritje në këtë drejtim. Kreu i Kuvendit tha se institucionet e mbështesin dialogun me Serbinë, prandaj edhe e kanë filluar atë dhe presin që të zgjidhen shumë çështje teknike e të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Krasniqi i kërkoi kryetarit të PE-së që të ushtronte ndikimin e tij dhe të Parlamentit, te pesë vendet e BE-së, të cilët nuk e kanë njohur Kosovën, ta bëjnë këtë, si dhe kërkoi një përkrahje më të madhe për procesin e liberalizmit të vizave për Kosovën e integrimin evropian.

Krasniqi i bëri ftesë kryetarit të Parlamentit Evropian që të vizitojë Kosovën.

Takimi me eurodeputetët Pack e Kukan

Kryetari i Kuvendit, Dr. Jakup Krasniqi dhe delegacioni që ai kryeson, janë takuar edhe me eurodeputetët, Doris Pack dhe Eduard Kukan, ky i fundit, njëherësh edhe kryetar i Delegacionit të Parlamentit Evropian për marrëdhënie me Ballkanin Perëndimor. Kryetari Krasniqi i ka njoftuar ata me zhvillimet në Kosovë dhe parashtroi edhe njëherë kërkesën për

qartësim të hapave që vendi ynë duhet të ndjekë për liberalizimin e vizave dhe procesin e integritit evropian.

Eurodeputetët, pasi vlerësuan si të padrejtë vonesën e liberalizimit të vizave për Kosovën, premtuan angazhim për të përshpejtuar këtë proces të rëndësishëm për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës.



“Ballkani Perëndimor – drejt një Evrope më të integruar”

Në kuadër të takimit të përbashkët parlamentar të organizuar nga Parlamenti Evropian dhe Kuvendi Kombëtar i Hungarisë, me temën :- “Ballkani Perëndimor – drejt një Evrope më të integruar” në Bruksel, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, duke e marrë fjalën, mes të tjerash tha se pas zgjedhjeve të përgjithshme, Kosova i ka konsoliduar institucionet dhe stabilitetin politik. Me gjithë vështirësitë e mëdha të një ekonomie të shkatërruar, theksoi Krasniqi, Kosova ka shënuar rritje ekonomike dhe ka përmirësuar mirëqenien e qytetarëve. “Ne kemi përmirësuar dukshëm infrastrukturën e dëmtuar rëndë dhe kemi arritur rindërtimin fizik të vendit. Aktualisht po realizojmë projektin e madh të autostradës, që e lidh Kosovën me bregdetin e Shqipërisë dhe Serbinë e më tej. Kemi ndërtuar gjithashtu një rrjet të tërë të telekomunikimeve”.

Në vijim z. Krasniqi, foli për krijimin e kushteve për tërheqjen e investi-

meve në Kosovë. Kosova tha ai, ka sanksionuar standarde të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut e të komuniteteve pakicë dhe po zbaton një politikë të drejtësisë shoqërore e të barazisë së qytetarëve. “Ne jemi të angazhuar për bashkëpunim dhe fqinjësi të mirë, për pajtim dhe paqe dhe për integrimin evropian. Kosova sot ndjen nevojën e ngutshme për ndihmën e BE-së për liberalizim të vizave dhe integrim euroatlantik”.

Kryeministri hungarez, i cili kryeson Këshillin Evropian, tha se zgjerimi i BE-së duhet vënë në rend të ditës, kurse kryetari i Komisionit Evropian, Jose Manuel Barosso, theksoi nevojën e reformave të ngutshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, afër të të cilave duhet të qëndrojnë të gjitha vendet anëtare të BE-së.

Gjatë vizitës, kryetari Krasniqi është shoqëruar nga kryetari i Komisionit parlamentar të Integritimit Evropian, Lufti Haziri, shefi i Kabinetit, Mehmet Hajrizi dhe këshilltari për Protokoll e Marrëdhënie Ndërkombëtare, Skënder Reçica.

André Flahaut: Të thellohen marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy parlamenteve



Një pritje të ngrohtë dhe miqësore, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pasur në Parlamentin e Belgjikës, nga kryetari i tij, z. André Flahaut.

Në takim u konfirmuan marrëdhëniet e mira midis dy parlamenteve, kryetarët e të cilëve edhe më parë kanë këmbyer vizita zyrtare.

Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Belgjikës, z. André Flahaut, tha se e kishte vizituar më herët Kosovën, në cilësi të ministrit të Mbrojtjes dhe ishte befasuar me ndryshimet e mëdha pozitive që ka bërë vendi ynë. Ai u interesua për aspekte të ndryshme të jetës në Kosovë, për të cilat e njoftoi kryetari Krasniqi.

Të dy kryetarët u pajtuan që të thellohen marrëdhëniet bilaterale ndërmjet parlamenteve, duke ditur se Kuvendi i Kosovës mund të përfitojë nga përvoja dhe tradita parlamentare belge. Ata theksuan nevojën e formimit të grupeve parlamentare të miqësisë dhe të takimeve të deputetëve të të dyja parlamenteve. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi e ftoi homologun e tij belg për një vizitë miqësore dhe zyrtare në Kosovë, e cila u prit me kënaqësi.

Stevens: Belgjika do ta mbështesë Kosovën

Gjatë takimit me zëvendëskryetaren e Senatit belg, znj. Helga Stevens, kjo e fundit konfirmoi edhe njëherë mbështetjen e pakursyer të Belgjikës për Kosovën. Ajo tha se Belgjika do ta mbështes Kosovën në drejtim të liberalizimit të vizave dhe të stabilitetit të saj.


Stevens vuri theksin tek marrëdhëniet e Kosovës me fqinjët, në mënyrë të veçantë me Serbinë, në dobi të paqes, sigurisë dhe të marrëdhënieve në rajon. Sipas saj, bisedimet me Serbinë në Bruksel janë të rëndësishme, sepse ato do t'i stabilizojnë marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy vendeve në të ardhmen.

Gjatë takimit u bisedua, gjithashtu, për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet parlamentet belg me Kuvendin e Kosovës.

Znj. Stevens u interesua për gjendjen në Kosovë, për zhvillimin ekonomik, papunësinë, sidomos për arsimimin e të rinjve, për kushtet e personave me aftësi të kufizuar, arsimin dhe integrimin e tyre. Ajo shprehu gatishmërinë e saj që të ndihmojë me çfarë të mundet dhe çfarë t'i kërkohet prej Kosovës.

Kryetari Krasniqi e ftoi znj. Helga Stevens që ta vizitojë Kosovën dhe të njihet për së afërmi me gjendjen atje. Ai, në kuptim të përpjekjeve për integrimin dhe përfshirjen sociale, për zhvillimin ekonomik e për arsimin, përmendi në mënyrë specifike dokumentet që i ka miratuar Kuvendi në vitet e fundit: njëri ka të bëjë me adoptimin e Deklaratës së Mileniumit dhe tjetri me agjendën evropiane të përfshirjes sociale, e quajtur Letra e Bardhë.

Gjatë kësaj vizite, kryetari Krasniqi shoqërohet nga Lufti Haziri, kryetar i Komisionit Parlamentar për Integritim Evropian, Mehmet Hajrizi, shef i Kabinetit të Kryetarit dhe Skënder Reçica, këshilltar për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.



Fjala e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Dr. Jakup Krasniqi, në Grupin e Punës të Takimit të Përbashkët Parlamentar në Bruksel

I nderuar anëtar i Parlamentit Evropian, zoti Hannes Swoboda

E nderuar anëtare e Parlamentit Evropian, zonja Doris Pack
Të nderuar kolegë parlamentarë

Tema bosht e punës së këtij Grupi "Bashkëpunimi në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë", paraqet çështje të një rëndësie të veçantë për vendet e Ballkanit Perëndimor, në rrugë drejt integrimit evropian. Në fjalën time do të paraqes shkurtimisht politikat dhe veprimet që ka ndër marrë vendi im në çështjet e kufijve, të vizave, migracionit dhe bashkëpunimit gjyqësor e policor.

Korniza ligjore e Kosovës në këto fusha është plotësuar dukshëm këto vitet e fundit, kurse aktual-

isht është në proces të rishikimit dhe përmirësimit legjislativ për të huajt, për azilin dhe menaxhimin e integruar të kufijve.

Në vijim të plotësimit të kriterëve të liberalizimit të vizave, Kosova ka nënshkruar marrëveshjet bilaterale për riatdhesim me Gjermaninë, Francën, Danimarkën, Zvicrën, Norvegjinë, Austrinë, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Belgjikën. Në fazën e përgatitjeve për nënshkrim të marrëveshjeve të ngjashme, jemi me Slloveninë, shtetet e Beneluksit, Çekinë, Kroacinë, Hungarinë, Estoninë dhe Letoninë. Kuvendi i Kosovës e ka miratuar gjithashtu edhe Ligjin për Ripranim, me të cilin obligohet për kthimin e qytetarëve të Kosovës që qëndrojnë me status të padefinuar jashtë territorit të saj.



Kryetari Krasniqi duke folur në Parlamentin Evropian

Me qëllim të rritjes së përkujdesjes institucionale për qytetarët tanë të riatdhesuar, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë e rishikuar për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Planin përkatës të Veprimit në nivel qendror dhe në atë lokal, duke rritur buxhetin për këtë veprimtari, nga 500.000 euro sa ishte vitin e kaluar, në rreth 3.5 milion euro për këtë vit. Për këtë qëllim janë ngritur edhe mekanizma përkatës, si Bordi Ndërmator për Riintegrim, Sekretariati i Bordit, Zyra e Pranimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, Zyra për Riintegrim, e cila në bashkëpunim me ministrinë e linjës po punon për ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal. Zyrrat Komunale për Kthim dhe Komunitete, veprojnë sipas një rregulloreje të miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 4 gusht 2010.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë hartuar dhe miratuar dy strategji kombëtare, njëjën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe tjetrën për Migracion. Që të dyja strategjitë kanë Planet e

Veprimit, të cilët janë në proces të zbatimit.

Qeveria e Kosovës ka inicuar procedurën e hartimit të politikave për vendosjen e regjimit të vizave në Republikën e Kosovës. Kjo politikë do të kontribuojë në avancimin e rregullimit të sistemit vendor në çështjet e migrimit dhe azilit, por plotëson edhe një kriter plus në procesin e liberalizimit të vizave dhe afrimit me standardet evropiane.

Në proces të kompletimit të kornizës ligjore për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufijve shtetërorë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar shtatë urdhëresa administrative, si për shënimin e vijës kufitare, për incidentet kufitare, për objektet brenda zonës së kalimit të kufirit, për kontrollin në pikat e kalimit kufitar, për kategorizimin e pikave të kalimit të kufirit, për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e vendosjes së shenjave paralajmëruese dhe shenjave të shkruara në pikat e kalimit të kufirit dhe në zonën e kalimit të kufirit dhe për ndalimin, kufizimin ose kushtëzimin e aktiviteteve të

caktuara përgjatë vijës së kufirit shtetëror në Akademinë Policore Turke, një memorandum bashkëpunimi me Shqipërinë për luftimin e krimit dhe për emergjenca, një deklaratë të përbashkët me Republikën e Francës për luftimin e rrjeteve të parregullta të imigrimit dhe rrjeteve të trafikimit me njerëz, një marrëveshje për bashkëpunim në fushën e sigurisë, me Republikën Federale të Gjermanisë dhe një memorandum të mirëkuptimit me Republikën e Kroacisë për luftimin e krimit të organizuar dhe luftimin e migracionit ilegal.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar tridhjetë propozim marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, të cilat iu kanë drejtuar ministrive të drejtësisë të vendeve të

rajonit, vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve me të cilat ka interes reciprok, sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, në çështjet civile dhe penale dhe deri më tani pëlqimin për të filluar negociimin, hartimin dhe finalizimin e marrëveshjeve e kanë dhënë Zvicra, Gjermania, Suedia, Norvegjia, Maqedonia, Italia, Turqia, Shqipëria, Belgjika dhe Luksemburgu.

Para disa ditësh në Prishtinë u mbajt takimi i Asociacioneve të Kolegjeve Policore Evropiane (AEPC). Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim është pranuar aty nga Bordi Qeverisës i AEPC, në cilësi të anëtarit vëzhgues.



Nga seanca në Parlamentin Evropian

Tashmë janë transferuar përgjegjësitë nga KFOR te Policia Kufitare e Kosovës për mbikëqyrjen e kufirit me Republikën e Maqedonisë, për dy sektorë, kurse sektori i fundit do të transferohet nga gjysma e këtij viti.

Presim që deri në fund të këtij viti të përfundojë edhe procesi i demarkacionit të kufirit me Republikën e Malit të Zi Sistemi BMS (Border management system) është instaluar në të gjitha pikat e kalimit të kufirit dhe shumë shpejt do të jetë funksional. Doganat e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje për asistencë të ndërsjellë me administratat doganore të Shqipërisë, Bullgarisë, Kanadasë, Kroacisë, Republikës Çeke, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Hungarisë, Irlandës, Italisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Norvegjisë,

Polonisë, Sllovenisë, Suedisë dhe Turqisë.

Me qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar policor, Ministria e Punëve të Brendshme ka inicuar procedurat për anëtarësim në INTERPOL dhe për bashkëpunim më të mirë me FRONTEX, edhe pse përmes EULEX-it tashmë ekziston një bashkëpunim i tillë.

Kosova ka arritur një bashkëpunim të mirë ndërkombëtar në fushë të sigurisë. Tash së voni midis Kosovës dhe Maqedonisë është nënshkruar marrëveshja për patrullime të përbashkëta në vijën kufitare.

Kemi marrëveshje bashkëpunimi edhe me Hungarinë për luftimin e krimit, një protokoll bashkëpunimi për trajnim të Policisë së Kosovës



Pamje nga Prishtina

“Progresi i Kosovës drejt integrimit evropian”



Më 19 – 20 maj u mbajt në Prishtinë takimi i katërt ndërparlamentar, Parlamenti Evropian – Kosova. Takimin e hapi Kryetari i Kuvendit, Dr. Jakup Krasniqi. Fillimin e punimeve të këtij takimi e kanë përshëndetur, kryetari i Grupit të Parlamentit Evropian, Eduard Kukan, Fernando Gentilini, Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë si dhe Khaldoun Sino, ushtrues detyre i udhëheqësit të Zyrës Ndërlidhëse të Këshillit të Europës me ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së.

Duke u uruar mirëseardhjen eurodeputetëve, z. Krasniqi ka theksuar se nga takimi i fundit, në vitin e kaluar, Kosova ka qenë e angazhuar seriozisht në përmbushjen e agjendës evropiane. Në Kuvendin e Kosovës po miratohen ligje, duke u përpjekur që të verifikohen për kompatibilitetin e tyre me legjislacionin evropian. Ai i ka garantuar mysafirët nga Parlamenti Evropian se të gjithë institucionet në të gjitha fushat e jetës në Kosovë janë në një reformim dhe transformim të vazhdueshëm, drejt procesit të integrimit evropian dhe liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Në temën e parë të takimit: “Progresi i Kosovës drejt integrimit evropian” shkëmbimi i pikëpamjeve mes Qeverisë së Kosovës, Përfaqësuesit Special të BE-së dhe Komisionit Evropian, ka folur z. Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë. Ai ka pohuar orientimin e Qeverisë dhe të institucioneve të Kosovës, por edhe të qytetarëve të vendit tonë në rrugën drejt integrimit evropian. Ai ka numëruar një varg masash, të cilat janë ndërmarrë në Kosovë në përmbushjen e sfidave që dalin në Raportin e Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian.



Kryetari i Komisionit për Integritime Evropiane, Lutfi Haziri, ka folur për punën e këtij komisioni në hartimin e Planit të Veprimit të Kuvendit për integrimin evropian, duke i theksuar se janë paraparë 118 veprime konkrete për përmbushjen e agjendës evropiane të Kosovës për këtë vit.

Raportuesja për Kosovë në Parlamentin Evropian, Ulrike Lunacek, ka folur për vullnetin e Parlamentit Evropian për hapjen e perspektivës evropiane për Kosovën dhe për procesin e liberalizimit të vizave. Por në këtë temë ka theksuar edhe vështirësitë e mëdha të vendeve të BE-së me emigrantët nga vende të tjera të rajonit që paraqiten si qytetarë të larguar nga Kosova. Ajo ndërkaq ka theksuar, se Parlamenti Evropian ka kërkuar nga Serbia heqjen e strukturave paralele në Veri të Kosovës. Për këtë pikë, kanë folur dhe kanë shtruar pyetje eurodeputetët: Tanja Fajon, Antonio Cancian etj.





Për sfidat e sistemit zgjedhor pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe reforma e kornizës ligjore që lidhet me zgjedhjet, ka raportuar Arsim Bajrami, kryesues i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ai ka theksuar nevojën që ka dalë për ndryshimet kushtetuese, sidomos sa i përket zgjedhjes së Presidentit të vendit, i cili do të zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët.

Kryesues i Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, Haki Demolli, ka folur për nevojën e këtyre ndryshimeve pas abuzimeve me votën e lirë në zgjedhjet e fundit në Kosovë, duke theksuar nevojën e ndryshimit të zonave zgjedhore dhe të listave zgjedhore.



Lidhur me progresin në reformat institucionale, në veçanti performancën e pushtetit lokal pas decentralizimit dhe gjendjen e sistemit arsimor, ka raportuar Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media. Ai është ndalur në reformat e administratës dhe të pushtetit lokal, duke i theksuar sidomos rezultatet e decentralizimit dhe krijimin e komunave të reja me shumicë serbe, si: Graçanicë, Kllokot, Ranillug e Partesh, si dhe për sukseset e shkollës së reformuar në Kosovë. Kurse nënkryetari i Kuvendit, Enis Kervan, ka folur për respektimin kushtetues të të drejtave dhe lirive të komuniteteve pakicë dhe për rezultatet e komunës së re të Mamushës.



Eurodeputetja, Doris Pack, ka shfaqur kënaqësi për të arriturat e arsimit në Kosovë, në të gjitha nivelet, si dhe për hapjen e Universitetit publik në Prizren, por gjithashtu ka tërhequr vëmendjen për kolegjet e shumta private në Kosovë, të cilat, siç është shprehur ajo, zhvasin shumë para dhe japin pak rezultate. Ajo ndërkaq i ka ftuar institucionet arsimore të vendit që shkollat e Kosovës të bëhen pjesë e programeve arsimore të vendeve të BE-së.



Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Albin Kurti, ka shprehur qëndrimin konsensual në Kosovë për integritet evropiane, por ka pasur vërejtje për qëndrimin e BE-së dhe të EULEX-it, për paradigmen për stabilitet të përkohshëm në Kosovë, në vend të paradigmës për zhvillim afatgjatë të Kosovës.

Në këtë temë ka folur edhe Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, duke e tërhequr vëmendjen për pasojat e decentralizimit etnik në Kosovë, kurse deputetja Myzejene Selmani ka tërhequr vëmendjen për pasojat e skadimit të marrëveshjes për preferencat tregtare dhe mospërfitjen e saj për Kosovën.



Për temën e forcimit të sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ka raportuar prapë, zoti Kuçi, i cili ka theksuar masat që janë ndërmarrë nga Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë për menaxhimin e sistemit të drejtësisë, legjisllacionin, për funksionalizimin e këtij sistemi, për funksionimin e ligjit në gjithë territorin e Kosovës, si dhe për strategjinë dalëse për EULEX-in. Temës në trajtim i kanë kontribuar edhe diskutues të tjerë si, Zenun Pajaziti, Jelko Kacin, Marije Cornelissen e të tjerë.

“Perspektiva ekonomike dhe sociale në kohën e krizës”



Sesionin e dytë të takimit të 4-t ndërparlamentar, Parlamenti Evropian – Kosova, e ka hapur Kryetari i grupit të Parlamentit Evropian, z. Eduart Kukan, i cili e ka vlerësuar të suksesshëm sesionin e parë dhe është shprehur optimist se do të arrihen rezultate edhe në këtë sesion, në përfundim të të cilit do të miratohet deklarata e përbashkët e dy kryetarëve.

Referuese e parë në temën: Perspektiva ekonomike dhe sociale në kohën e krizës, ka qenë eurodeputetja, Jutta Steinruck. Ajo ka theksuar se gjatë dy ditëve në Kosovë ka parë varfëri, ndërkaq ka tërhequr vëmendjen se politikanët duhet të bëjnë më shumë për jetë më të mirë të qytetarëve. Ajo e ka vlerësuar të brishtë gjendjen ekonomike në Kosovë, sidomos në kushtet e krizës ekonomike globale, e cila bën që të ketë më pak investime të huaja në ekonominë e vendit. Duhet të punohet për shkollim dhe punësim më të madh të të rinjve dhe për krijimin e mjedisit të përshtatshëm biznesor.” Nuk duhet të prisni gjithçka nga Evropa dhe bashkësia ndërkom-bëtare, por duhet të bëni vetë më shumë për vetën tuaj”, ka porositur ajo.



Duke folur në këtë temë Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka theksuar angazhimin e Qeverisë për të përmirësuar gjendjen ekonomike të vendit, duke përmendur në këtë dritë rreth dhjetë ligje të kësaj sfare që duhet të miratohen gjatë muajit qershor. Ai tutje ka theksuar objektivat e qarta të ekzekutivit të vendit për zhvillim ekonomik, sidomos në planin e energjetikës dhe të shfrytëzimit të resurseve të tjera të pasura të Kosovës. Pajaziti ka folur edhe për barrierat ekonomike që i bëhen Kosovës, si dhe ka ftuar parlamentarët evropian që të angazhohen për rikthimin e preferencave tregtare të mallrave të Kosovës në vendet e BE-së.

Antonio Cancian ka mbajtur qëndrim që për zhvillim të shpejtuar të vendit nuk mjafton tregu nacional, por një treg më i gjerë rajonal. Ai u ka sugjeruar autoriteteve të Kosovës, ndërkaq, që paraprakisht duhet t'i qartësojnë idetë për zhvillim, të miratojnë legjislacion të mirë dhe monitorojnë të gjitha fushat e investimeve dhe të shpenzimit të parasë.



Anëtarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Myzejane Selmani, ka theksuar bllokimin e mallrave të Kosovës, me gjithë anëtarësimin e vendit në CEFTA dhe ka ftuar që Kosova të ndihmohet për zhvillim më të shpejtë dhe për krijimin e mjedisit të shëndoshë biznesor. Jellko Kacin ka përkujtuar kohërat kur shumë produkte cilësore të Kosovës gjenin vend në treg. Ai ka theksuar se ka vend që shumë produkte të tilla, si verërat e Kosovës, rishtas mund të afirmohen në tregjet e vendeve të rajonit dhe të Evropës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pohuar gjendjen jo të mirë të ekonomisë, por ka theksuar gjithashtu përparesitë e Kosovës për zhvillim, si: infrastruktura e mirë ligjore për biznes, siguria e mirë në vend, politika e favorshme fiskale etj. Ai ka ngritur, ndërkaq edhe shqetësime për defektet që e kanë përcjellë procesin e privatizimit në Kosovë, ndërprerjen e preferencave tregtare për Kosovën dhe mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Doris Pak ka pasur vërejtje serioze për moszhvillimin e duhur të bujqësisë në Kosovë, lëm ky që kërkon pak investime, nuk varet shumë nga importi, dhe punëson numër relativisht të madh të fuqisë punëtore.

Për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe bashkëpunimin më të gjerë rajonal, ka raportuar Jellko Kacin (raportues për Serbinë në Parlamentin Evropian). Ai

e ka quajtur shumë pozitiv dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, kurse ka thënë se skenat e protestave në Kosovë, gjatë vizitës së z. Stefanoviç në Kosovë, kanë përçarur mesazhe jo të mira për vendin.

Albin Krti i ka quajtur të dëmshme bisedimet me Serbinë për shkak të asimetrisë së tyre dhe për faktin që bisedohet me Serbinë për Kosovën. Ai tutje ka përkujtuar lëshimet e Kosovës në Rambuje dhe në Vjenë, duke shtuar se për shkak të koncesioneve që priten të bëhen, Kosova do të bijerë nën Planin e Ahtisarit. Ai e ka kritikuar BE-në për lëshimet që i bën Tadiçit, në emër të anëtarësimit të Serbisë në BE, duke theksuar se Serbia që nga koha e Pashiqit konfliktet historike me shqiptarë i projektojnë si të natyrës, kurse konfliktet etnike i projektojnë si konflikte kulturore.

Raportuesja për Kosovë në Parlamentin Evropian, Ulrike Lunacek, duke e mbështetur

dialogun e ka garantuar z. Kurti dhe të tjerët se BE-ja nuk do të lejojë ndarjen e Kosovës as krijimin e ndonjë “Republika Serbska “ në Kosovë.

“Koncesionet e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Serbisë kanë qenë çdo herë kontraproduktive”, ka theksuar deputeti Hydajet Hyseni, kurse edhe Arsim Bajrami dhe Zenun Pajaziti janë shprehur se Serbia nëpërmjet fillimit të dialogut dëshiron të fitojë kohë dhe të hapë rrugën për anëtarësim në BE. Doris, Pak, është pajtuar se Serbia i ka qëllimet e saj, por ka kërkuar që edhe Kosova të përfitojë nga dialogu. Jelko Kacin, ndërkaq, është shprehur i bindur se klasa e re politike në Serbi do të jetë bashkëpunuese me BE-në, por edhe me Kosovën.

Në përfundim të takimit të dy delegacionet kanë miratuar një deklaratë të përbashkët të dy kryetarëve, Kukan dhe Krasniqi.

Konferencë shtypi Krasniqi - Kukan

Parlamenti Evropian mbështet të ardhmen evropiane të Kosovës. Rikonfirmohen edhe njëherë marrëdhëniet e shkëlqyera me Parlamentin Evropian, qëndrimi i qartë dhe i avancuar që ka ai ndaj shtetit të Kosovës, si dhe mbështetja e pakursyer që Bashkimi Evropian po vazhdon t' i japë Kosovës



Eduard Kukan - Jakup Krasniqi

Pas përfundimit të takimit të përbashkët Parlamenti Evropian – Kosova, u mbajt një konferencë e përbashkët për media e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi dhe kryetarit të Grupit të Parlamentit Evropian, Eduard Kukan. Kryekuvendari Krasniqi duke njoftuar mediat se ka përfunduar punimet Takimi i Katërt vjetor - Parlamenti Evropian–Kosova, shprehu kënaqësinë për përmbajtjen e takimit, për përfundimet që u nxorën dhe për deklaratën e përbashkët që u miratua. "Për dy ditë rresht ne kemi trajtuar tema të rëndësishme për zhvillimet aktuale nëpër të cilat po kalon Kosova, si: integrimi evropian, reformat institucionale, decentralizimi, sistemi arsimor, sundimi i ligjit dhe lufta kundër krimit të organizuar e korrupsionit; perspektiva ekonomike e sociale, bashkëpunimi rajonal dhe dialogu me Serbinë etj. Parlamentarët evropianë dhe diskutuesit vendorë dhanë kontribute të çmueshme në shqyrtimin e agjendës së ngjeshur", theksoi kreu i legjislativit të vendit.

Ky takim, tha z. Krasniqi, rikonfirmoi edhe njëherë marrëdhëniet e shkëlqyera me Parlamentin Evropian, qëndrimin e qartë dhe të avancuar që ka ai ndaj shtetit të Kosovës dhe për mbështetjen e pakursyer që Bashkimi Evropian po vazhdon t' i japë Kosovës.

Kryekuvendari Krasniqi falënderoi mbarë delegacionin parlamentar evropian, ndërsa në mënyrë të veçantë z. Kukan, për qëndrimet e tyre

mbështetëse dhe për kontributin e çmuar që dhanë. Z. Krasniqi shprehu besimin se konkluzionet e arritura do të trajtohen seriozisht nga faktorët që ato iu adresohen.

Kryetari i Parlamentit Evropian, Eduard Kukan, në fillim theksoi se në këtë takim pati diskutime shumë të mira, të shoqëruara nga besimi i ndërsjellë dhe klima shumë e mirë që u krijua ndërmjet dy delegacioneve. Parlamenti Evropian mbështet të ardhmen evropiane të Kosovës, ndaj në këtë frymë u theksua nevoja që Bashkimi Evropian të trasojë rrugën dhe të përcaktojë kushtet për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave. Në këtë frymë rëndësi shumë të madhe ka nisja e reformave, në bazë të të cilave do të krijohet një jetë më e mirë për qytetarët, siç është ulja e papunësisë, si dhe zgjidhja e problemeve të tjera jetësore për popullin e Kosovës, sepse kjo është detyrë e politikanëve, pra t' iu shërbejnë qytetarëve të tyre, dhe kjo duhet të kihet gjithnjë para sysh kur flitet për liberalizimin e vizave, reformën zgjedhore, luftën kundër korrupsionit dhe për të gjitha çështjet tjera. Z. Kukan shprehu kënaqësinë për gatishmërinë e treguar nga ana e përfaqësuesve vendorë për vazhdimin e këtyre reformave. "Nga Kosova po largohemi me një ndjenjë të mirë, kishim një takim shumë të dobishëm e të frytshëm, i cili do të japë rezultate", theksoi kryetari i Parlamentit Evropian, Eduard Kukan.

DEKLARATË E PËRBASHKËT

*Në përfundim të takimit të 4-t ndër parlamentar
Parlamenti Evropian-Kuvendi i Kosovës,
i mbajtur në Prishtinë më 19-20 Maj, 2011, dy kryesuesit:*

1. Mirëpritën krijimin e qeverisë së re dhe zgjedhjen e shpejtë të presidentit pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese; megjithëse shprehën keqardhje për parregullsitë që karakterizuan këto zgjedhje dhe i bënë thirrje qeverisë së re që menjëherë të rifilloj punën për reformat më të rëndësishme.

2. Theksuan rëndësinë e liberalizimit të vizave si një nxitje e fuqishme për Kosovën që tëndërmarr reformat e nevojshme, por nënvizuan se kjo nuk duhet konsideruar si i vetmiprioritet kyç për Kosovën, duke lënë kështu në hije adresimin e çështjeve të tjera si atoeconomike dhe sociale; duke çmuar përpjekjet e deritanishme të institucioneve përpëmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave; theksuan se Kosova është i vetmi vend në rajon qytetarët e së cilës nuk mund të udhëtojnë lirshëm në BE dhe se kjo situatë krijon ndjenjën e izolimit, në veçanti për të rinjtë, studentët dhe profesionistët që merren me çështjet që lidhen me BE-në; konsideruan që Komisioni Evropian duhet të iniciojë dialogun për liberalizimin e vizave dhe pa u vonuar të përcaktojë fazat e këtij procesi.

3. Mirëpritën fillimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe theksuan se dialogut i përkasin çështjet që janë shumë të rëndësishme për ta përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve të të dyja palëve dhe se është në interes të tyre thelbësor se rezultatet e qarta do të arrihen me përpikëri; dhe nënvizuan se rezultati i suksesshëm i dialogut do të shënohet një arritje të madhe në bashkëpunimin rajonal. Për këtë qëllim, mirëpritën faktin se takimet e para janë mbajtur në një atmosferë të mirë dhe konstruktive dhe se tanimë është bërë progres; theksuan rëndësinë e komunikimit të qartë me qytetarë, qëllimin dhe rezultatin e dialogut;

4. Mirëpritën faktin që zgjedhjet e para të përgjithshme që nga pavarësia e vendit dhe umbajtën nën përgjegjësinë e vetme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës më 12 Dhjetor 2011. Megjithatë, theksuan si çështje serioze një numër të madh të parregullsive të raportuara gjatë zgjedhjeve, të cilat ndikuan në besimin e qytetarëve në procesin demokratik; përshëndetën formimin e shpejtë të komisioneve për reformën zgjedhore, përfshirjen e atyre ekzistuese dhe fillimin e punës në këtë drejtim;

5. Mirëpritën vullnetin politik të të gjitha partive politike, duke përfshirë qeverinë dhe opozitën, për të përkrahur reformën e legjislacionit kushtetues dhe elektoral; bënë thirrje qeverisë dhe parlamentit që menjëherë të fillojnë punën për të harmonizuar legjislacionin vendor me standardet ndërkombëtare dhe i inkurajuan ata që të përdorin mbështetjen dhe ekspertizën të ofruar nga komuniteti ndërkombëtar; theksuan rëndësinë shumë të madhe të hetimit të të gjitha parregullsive lidhur me zgjedhjet dhe të ndjekjes penale të autorëve të tyre në mënyrë transparente dhe me kohë; bënë thirrje për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave në raportimin e rezultateve të hetimeve të këtyre hetimeve, tek publiku i gjerë.

6. Mirëpritën përpjekjet për të forcuar Parlamentin dhe institucionet Qeveritare, dhe ritheksuan rolin e Kuvendit të Kosovës dhe në veçanti mekanizmave që sigurojnë mbikëqyrjen efikase të Qeverisë, por njëkohësisht theksuan nevojën për forcimin e mëturjeshëm të funksioneve të Kuvendit, duke u mundësuar deputetëve që të përmbushin me efikasitet dhe efektivitet mandatin e tyre.

7. Theksuan rëndësinë e institucioneve të fuqishme dhe efikase në sektorin e gjyqësorisë dhe prokurorisë si një element i domosdoshëm në përkrahje të sundimit të ligjit poashtu edhe si një kriter thelbësor në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian; theksuan rëndësinë e tyre të veçantë në arritjen e suksesit në luftimin kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të cilat shihen nga qytetarët si probleme kryesore në vend, psh. duke krijuar mekanizmat të cilët do të mundësonin ngrirjen e fondeve dhe konfiskimin e pasurisë së personave të përfshirë në krim të organizuar.

8. Ritheksuan rolin e rëndësishëm që luan EULEX-i dhe institucionet vendore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; theksuan pritjet e tyre se misioni do të zgjerojë prezencën dhe funksionimin në Veri të Kosovës; në bazë të një bashkëpunimi të dyanshëm në mes të misionit të EULEX-it dhe autoriteteve lokale dhe qendrore;

9. Mirëpritën deklarimet e autoriteteve të Kosovës rreth mbështetjes së plotë për verifikimin e deklaratave për dyshime të miratuara në rezolutën e PACE të datës 25 Janar 2011 (“Raporti i Marty-t”) dhe shprehën besimin e tyre në EULEX-in për përgatitjen e një hetimi të plotë të deklaratave për dyshime, në veçanti duke krijuar një program të sigurt dhe të avancuar për mbrojtje të dëshmitarëve, i cili program është i nevojshëm për të filluar hetimin. 10. Ritheksuan se mbrojtja e të drejtave të minoriteteve etnike dhe seksuale është e rëndësishme për ndërtimin e një shoqërie vërtet të hapur, tolerante dhe demokratike. Me këtë rast u bënë thirrje autoriteteve që në mënyrë aktive të angazhohen për promovimin dhe mbrojtjen vlerat e një shoqërie pluraliste me diversitet, pjesë integrale e së cilës do të jenë të gjitha minoritetet etnike dhe seksuale.

11. Theksuan rëndësinë e procesit të decentralizimit, i cili është thelbësor edhe për të krijuar struktura efikase lokale administrative, në shërbim të qytetarëve, edhe për të arritur qëllimin për një Kosovë multietnike; mirëpritën transferin e vazhdueshëm të kompetencave nga komunat amë në komunat e reja; bënë thirrje qeverisë që të bëjë një orar të qartë për komu

nat e reja që të marrin të gjitha përgjegjësitë e tyre; shprehën nevojën e procesit të decentralizimit edhe në veri të vendit, me qëllim të integritetit të komunitetit serb në jetën institucionale të Kosovës; Theksuan se integrimi i të gjitha komuniteteve duhet të arrihet përmes zhvillimit socio-ekonomik dhe jo vetëm përmes decentralizimit në baza etnike.

12. Rikujtuan faktin se një shoqëri civile vitale është një nga përbërësit esencial të demokracisë moderne, dhe u bënë thirrje autoriteteve që në diskutimet për çështjet kryesore me interes për Kosovën në nivel qendror, të përshijnë spektrin e gjerë të shoqërisë civile dhe të konsultohen me përfaqësuesit e OJQ-ve në procesin e hartimit të legjislacionit.

13. Cekën rëndësinë e politikave koherente ekonomike dhe nevojën për t’iu shmangur deficiteve të paqëndrueshme të buxhetit me qëllim që të mbahet stabiliteti makroekonomik; ftuan qeverinë që të përdorin ekspertizën e organizatave ndërkombëtare financiare, siç është FMN dhe Banka Botërore; Shpalosën shqetësimet për rritjen e deficitit tregtar të Kosovës nga viti 2008, në raport me vendet si Bosnia dhe Hercegovina dhe Serbi, dhe i bënë thirrje BE-së që të përshpejtojë procesin rreth arritjes së marrëveshjes në mes të BE-së dhe Kosovës për trajtimin preferencial të Kosovës në marrëdhëniet tregtare.

14. Shprehën shqetësimin për zhvillimet e fundit në ekonominë e Kosovës, me theks të veçantë në dobësitë financiare që karakterizohen nga deficitin e dyfish të, duke filluar nga deficitin aktual financiar, por edhe nga deficitin fiskal që është më modest por mjaft domethënës. Gjithashtu theksuan se aftësia e ekonomisë së Kosovës për të qenë konkurrenente ndërkombëtarisht pamundësohet nga rritja e tepruar e pagave në sektorin publik dhe ritmi i ngadaltë i hapjes së vendeve të punës; nënvizuan se për të mënjeluar përkeqësimin e situatës financiare, Qeveria e Kosovës duhet të negociojë me FMN-në në mirëbesim dhe ti sjell ata para një konkluzioni të suksesshëm sa më parë që është e mundur.

15. Shpalosën shqetësimet për situatën e rëndë ekonomike të Kosovës dhe ndikimin që ajo ka në standardet e jetesës së qytetarëve; theksuan papunësinë e lartë, e përbashkët tek të gjitha vendet e rajonit, e cila nuk e lejon Kosovën që ta arrij potencialin e saj të plotë ekonomik dhe e cila drejton kah rritja e zhgënjimit të qytetarëve; bënë thirrje qeverisë që të vazhdojë përpjekjet për të mbrojtur qytetarët, në veçanti grupet më të cenushme, nga efektet e krizave financiare;

16. Bënë thirrje për zbatimin e procedurave të avancuara dhe transparente të prokurimit publik, të cilat do të joshnin investimet e huaja private, në kuadër të kornizës së Partneritetit Publiko-Privat.

17. Vënë në pah projektin e ri të termocentralit 600 MW të bazuar në djegien e linjitet të bashkëfinancuar nga Banka Botërore, do të mundëso rehabilitimin e Kosovës B dhe të nxjerrë nga funksioni Kosovën A. U bënë thirrje autoriteteve të Kosovës dhe Bankës Botërore që të kenë parasysh synimet e Komisionit Evropian për zvogëlimin e emetimit të CO2 dhe të konsiderojnë zhvillimin e planeve për efikasitetin energjetik dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë.

18. Ritheksuan rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në procesin e integritetit në BE të të gjitha vendeve të rajonit; bënë thirrje për zgjidhje pragmatike për ta përfshirë Kosovën plotësisht në bashkëpunim rajonal; në lidhje me këtë, bënë thirrje për një zgjidhje të shpejtë të problemeve që pengojnë funksionimin e CEFTA-s; cekën efektet pozitive që rifillimi i tregtisë me të gjitha shtetet fqinje do të kishte në ekonominë e Kosovës dhe në krijimin e vendeve të reja të punës; bënë thirrje për përfshirjen e plotë të Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë që do të përqendrohen në rajon, me qëllim të favorizimit të zhvillimit të brendshëm dhe lidhjeve ndërkombëtare të nevojshme për të shtyrë rajonin drejt rritjes ekonomike.



KONFIRMOHET MBËSHTETJA HOLANDEZE PËR KOSOVËN

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, nga 20 deri më 24 prill 2011, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Mbretërinë e Holandës, gjatë së cilës është takuar me kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve të Holandës, znj. Gerdi Verbeet, me z. René van der Linden, kryetar i Senatit të Holandës, si dhe me zyrtarë tjerë të lartë të institucioneve holandeze.

Kryetari Krasniqi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë dhe ambasadori ynë në Holandë, Nexhmi Rexhepi, është pritur në një takim të ngrohtë dhe miqësor, nga kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të Mbretërisë së Holandës, znj. Gerdi Verbeet dhe në një takim të veçantë nga Komisioni për Çështje Evropiane dhe Politikë të Jashtme, të cilin e kryesonte z. Van Bonmel.

Nevojë për përshpejtimin e procesit të liberalizimit të vizave

Në këto takime, kryetari Krasniqi pasi falënderoi zyrtarët holandezë për kontributet që shteti i tyre ka dhënë për Kosovën, që nga angazhimet e tij në forcat ndërhjësore të NATO-s, të KFOR-it e të EULEX-it, për njohjen e hershme të pavarësisë së Kosovës dhe për mbrojtjen e saj në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, konstatoi që marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës janë të shkëlqyeshme. Ai i njoftoi mikpritësit me situatën e brendshme në Kosovë, për stabilitetin e saj politik, zgjedhjet, konsolidimin e institucioneve demokratike, ndërtimin e shtetit ligjor, mbrojtjen të drejtave të pakicave dhe për problemet që ka Kosova në veriu e saj. Kreu i Kuvendit foli gjithashtu edhe për fqinjësinë e mirë më shtetet fqinje, përveç me Serbinë, e cila, sipas Krasniqit, ende nuk është e gatshme që të vendosë marrëdhënie me Kosovën. Ai foli edhe për bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.


Kreu i Kuvendit z. Krasniqi tha: “Ne presim që Komisioni Evropian shumë shpejt të na japë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe qartësimin e hapave që duhet të ndjekë Kosova”. Raporti i Dik Martit ka dëmtuar opinionin ndërkombëtar për Kosovën duke ndikuar në uljen e njohjeve të reja. Ai sqaroi pastërtinë e luftës çlirimtare të Kosovës si dëshirë dhe vullnet qindravjeçar i popullit të Kosovës.

Në Kosovë ka mbi dyzet biznese holandeze, si në tregti, prodhim, shërbime etj. Kosova ka nevojë për shtimin të investimeve holandeze ndaj marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona dhe në mënyrë të veçantë ndërmjet dy parlamenteve, lindin nevojën e shpeshimit të kontakteve dhe thellimin e marrëdhënieve ndërparlamentare. Kosova po krijon kushte të favorshme për investimet e huaja. Ne shtoi z. Krasniqi e vlerësojmë drejtë edhe nënshkrimin e atyre marrëveshjeve të trashëguara nga ish-Jugosllavia, si për tregti, transport, shërbime ajrore, kulturë, sigurim social, anulim të taksave të dyfishta, marrëveshjen për riatdhesim (që hyn në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave) etj.

Autoriteteve holandeze, z. Krasniqi iu kërkoi ndihmë për njohjen e gjerë ndërkombëtare, që i duhet kaq shumë Kosovës dhe paraqiti pengesën e madhe që i vjen Kosovës nga mosnjohja prej të gjithave vendeve të Bashkimit Evropian. Ai kërkoi gjithashtu, që Kosova të trajtohet njësoj sikurse të gjitha shtetet e tjera të rajonit, në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe në takimet rajonale e ndërkombëtare, si dhe kërkoi ndihmë në procesin e integritimit evropian e të krijimit të marrëdhënie kontraktuale ndërmjet BE-së dhe Kosovës, si dhe për rikthimin e marrëveshjes për masat preferenciale tregtare.

Z. Krasniqi e ftoi kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve të Mbretërisë së Holandës për një vizitë zyrtare në Kosovë. Komisioni parlamentar për Çështje Evropiane dhe Politikë të Jashtme, ndërkaq, do të vijë në Kosovë gjatë muajit maj të këtij viti.

NË PARLAMENTIN E HOLANDËS KA PASUR GJITHMONË PËRKRAHJE PËR KOSOVËN



Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të Mbretërisë së Holandës, znj. Gerdi Verbeet, pasi i uroi mirëseardhje kryetarit Krasniqi, tha se në Parlamentin e Holandës ka pasur gjithmonë përkrahje për Kosovën. “Ne kemi kontribuar në NATO dhe e kemi njohur Kosovën me një përkrahje shumë të gjerë në parlament. Edhe sot, parlamenti holandez i jep një përkrahje shumë të fuqishme Kosovës në procesin e integrimit të saj në BE. Ne kemi kritere strikte por të ndershme, për këto procese”, theksoi ajo, ndërsa shtoi se Kosova ndodhet në hapat e parë drejt integrimit.

Verbeet tha se kjo vizitë është shumë e qëlluar dhe do t'i kontribuojë thellimit të marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve dhe vendeve tona. Ajo theksoi që Dhoma e Përfaqësuesve e Mbretërisë së Holandës, i kushton rëndësi të madhe sundimit të ligjit dhe demokracisë në Kosovë.

Në Komisionin për Çështje Ev-

ropiane dhe Politikë të Jashtme, diskutuan pothuajse të gjithë anëtarët e komisionit që ishin të pranishëm, kurse kryesuesi i tij, e quajti këtë një vizitë historike, sepse, siç tha ai, është e para e këtij niveli nga Kosova në Holandë.

Të gjitha çështjet që i parashtroui z. Krasniqi para komisionit, z. Van Bonmel tha se janë në një debat parlamentar në Holandë. Anëtarë të këtij komisioni i bënë pyetje të shumta kryetarit Krasniqi, të cilat kishin të bënin me marrëdhëniet me Serbinë, diplomacinë parlamentare, mundësinë e zhvillimit të takimeve ndërmjet deputetëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë, dialogun që po zhvillohet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, raportin e Dik Martit, raportet e shtetit të Kosovës me fenë, decentralizimin etj. Kryetari Krasniqi bëri sqarimet e nevojshme për të gjitha çështjet që parashtruan anëtarët e këtij komisioni.

LINDEN RIKONFIRMOI PERSPEKTIVËN EVROPIANE TË KOSOVËS



Krasniqi - Linden



Gjatë vizitës, kryetari Krasniqi dhe delegacioni që e shoqëronte, janë pritur nga kryetari i Senatit holandez, z. Rene van der Linden. Në takim ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm, z. Geert Jan Hamilton, drejtori i Përgjithshëm për bashkëpunim evropian në Ministrinë e Jashtme z. Robert de Groot, drejtori për Ballkanin, z. Cas van der Hoorst dhe përgjegjësi për Kosovën në këtë ministri, z. Thomas Claassen.

Kryetari Krasniqi i falënderoi zyrtarët e holandezë për ndihmën dhe mbështetjen e gjithanshme që Holanda i ka dhënë Kosovës dhe pasi konfirmoi marrëdhëniet e shkëlqyeshme midis dy vendeve, paraqiti në vija të përgjithshme gjendjen në Kosovë dhe problemet e vështirësitë me të cilat ajo po ballafaqohet. Krasniqi i bëri edhe disa kërkesa për Mbretërinë e Holandës, që lidheshin me liberalizimin e vizave e të integritimit evropian.

Kryetari i Senatit të Mbretërisë së Holandës, Rene van der Linden, rikonfirmoi perspektivën evropiane të Kosovës, ndërsa tha se koha e integritimit evropian varet shumë nga vet Kosova, se sa do të jetë në gjendje ajo t'i përmbush kriteret. Sidoqoftë, ai bëri thirrje për realizimin e reformave të nevojshme në të gjitha fushat.

Ai tha se Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm përpara dhe duke e vlerësuar këtë, konstatoi se BE-ja i ka më rigorozet kriteret për liberalizimin e vizave edhe për integritimin evropian, se që i kishte më përpara, prandaj, sipas tij, duhet të punohet shumë që të plotësohen ato.

Linden vlerësoi se sundimi i ligjit është çelë-

si i demokracisë, prandaj i duhet dhënë kaq shumë rëndësi, ndërsa foli edhe për nevojën që drejtësia të jetë e pavarur dhe të bëjë punën e saj profesionale, sikurse edhe mediat.

Ai shprehu kënaqësinë që kanë filluar bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe konsideroi që kjo ka shumë rëndësi për të ardhmen e përbashkët të të dyja vendeve. Kryesensori holandez u interesua edhe për marrëdhëniet e Kosovës me Shqipërinë dhe vendet e tjera fqinje, për të cilat i foli kryetari Krasniqi.

Sa i përket liberalizimit të vizave, ai tha se personalisht është në favor të kësaj çështjeje, por tha se duhet punuar që të plotësohen kriteret për të arritur atje. Kurse sa i përket ekonomisë, ai e vuri theksin te lufta kundër korrupsionit, si një dukuri jo vetëm në Kosovë.

Duke folur për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha vendet e BE-së, Linden konstatoi se nuk është i lehtë menaxhimi i kësaj situatë.

Kryeparlamentari Jakup Krasniqi foli për lirinë e mediave, për të drejtat e njeriut e të komuniteteve pakicë, për marrëdhëniet e mira fqinjësore me Shqipërinë, Malin e Zi e Maqedoninë dhe për gatishmërinë e Kosovës për të vendosur marrëdhënie edhe me Serbinë, por që aktualisht ajo nuk është e gatshme ta bëjë këtë. Kryetari Krasniqi tha se të kaluarën ia kemi lënë historisë, kurse politika merret me të sotmen dhe të ardhmen. Duke folur për liberalizimin e vizave, Krasniqi shtroi nevojën që Kosova të nxirret nga getoja në të cilën gjendet aktualisht.

Në takimin me Komisionin e Jashtëm: Sundimi i ligjit dhe demokracia - tema preokupuese



Takimi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Ministrinë e Jashtme

Edhe takimi me zyrtarët e lartë në Ministrinë e Jashtme kaloi në frymë të ngrohtë e miqësore. Drejtori Robert de Groot foli për marrëdhëniet e mira të shtetit të tij me Kosovën, ndihmën që Holanda ka dhënë për vendin tonë dhe konfirmoi gatishmërinë që ajo të vazhdojë edhe në proceset integruese të Kosovës dhe në zhvillimin e saj. Ai vuri theksin te rëndësia e dialogut që ka filluar me Serbinë, duke shfaqur gatishmërinë për të stimuluar të dy palët që ta shtojnë përpara atë. De Groot tha se ardhmja evropiane e Kosovës është e sigurt dhe kjo nuk duhet të diskutohet, por tha se duhet të diskutohet për rrugët që duhet të ndjekë Kosova drejt kësaj të ardhmeje.

Sundimi i ligjit dhe demokracia ishin dy tema që e preokupuan edhe këtë takim, sepse, siç tha de Groot, të dyja janë në vëmendje të Bashkimit Evropian, jo vetëm për vendet që aspirojnë të hyjnë aty, por edhe për vetë vendet e BE-së, ndërsa vlerësoi rolin e Kuvendit në këtë drejtim. Ai u interesua për reformat zgjedhore dhe kushtetuese që pritet të bëhen në Kosovë si dhe për rolin e kontrollit që ka Kuvendi mbi Qeverinë.

Kryetari Krasniqi e njoftoi atë për zhvillimet aktuale në Kosovë, ndërtimin e demokracisë së re e të institucioneve demokratike, për pozitën e komuniteteve pakicë, problemet në veri, marrëdhëniet e

fqinjësisë së mirë e për dialogun me Beogradin. Ai kërkoi mbështetje nga qeveria holandeze për proceset integruese të Kosovës dhe njohjen e mëtejme ndërkombëtare të saj.

Në të dyja këto takime zyrtarët e lartë holandezë folën për raportin e Dik Martit duke potencuar se është në interesin e Kosovës që sa më shpejtë të sqarohen çështjet e ngritura në këtë raport. Përkitazi me këtë, kryetari Krasniqi foli për luftën e pastër të UÇK-së dhe tendencat në raportin e Martit, duke u pajtuar që drejtësia sa më parë të thotë fjalën e saj dhe të sqarojë gjithçka, në mënyrë që t'i hiqet kjo barrë që i është vënë pa të drejtë Kosovës.

Kryetari Krasniqi i ftoi për vizitë në Kosovë kryetarin e Senatit, Linden dhe drejtorin e Përgjithshëm për bashkëpunim evropian në Ministrinë e Jashtme, de Groot.

Kryetari Krasniqi, i cili gjatë kësaj vizite shoqërohej nga ambasadori ynë në Holandë, Nexhmi Rexhepi, shefi i Kabinetit të kryetarit, Mehmet Hajrizi dhe këshilltari për Protokoll e Marrëdhënie Ndërkombëtare, Skënder Reçica, është takuar edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, z. Philippe Couvreur dhe i ka bërë një vizitë ambienteve të kësaj gjykate, ndërsa një takim të veçantë e ka pasur me bashkatdhetarët tanë në Mbretërinë e Holandës.

Vizita e delegacionit të Kuvendit të Kosovës e kryesuar nga kryeparlamentari Jakup Krasniqi në Itali

ITALIA



Kryeparlamentari Krasniqi u takua me presidentin e Dhomës së Deputetëve të Parlamentit Italian, z. Gianfranco Fini

U bisedua për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe parlamenteve. Të dy kryetarët ranë dakord për formimin e grupeve parlamentare të miqësisë dhe u dakorduan që rreth kësaj të fillojnë menjëherë procedurat. Në parlamentin italian ka pasur gjithmonë përkrahje për Kosovën



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti e Glauk Konjufca, ambasadori i Republikës së Kosovës në Romë, Albert Prenkaj, dhe nga këshilltarët Bilall Sherifi e Skender Reçica, ka filluar vizitën zyrtare në Itali.

Gianfranco Fini, kryetar i Dhomës së Deputetëve të Parlamentit Italian, hapi serinë e takimeve të shumta të delegacionit të Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga kryeparlamentari Krasniqi. Në këtë takim, kryetari Krasniqi e falënderoi z. Fini për pritjen miqësore dhe për kontributin që Italia ka dhënë për Kosovën që nga angazhimet e saj në forcat ndërhyrëse të NATO-s deri në misionet e KFOR-it e të EULEX-it. Njohja e hershme të pavarësisë së Kosovës, ka konstatuar kështu marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Kosovës dhe Italisë. Në vijim, z. Krasniqi e njoftoi mikpritësin për zhvillimet aktuale në Kosovë, zgjedhjet e dhjetorit të vitit të kaluar, zgjedhjen e presidentit e të qeverisë, konsolidimin dhe funksionalizimin e institucioneve demokratike dhe integrimin e komuniteteve. Një theks të veçantë, z. Krasniqi e vuri te problemet në veri të Kosovës, si pasojë e obstrukcioneve të Beogradit. Ambasadori italian Giffoni, si përfaqësues evropian, me angazhimin e tij është duke ndikuar në uljen e tensioneve në këtë pjesë të Kosovës. Kosova kafqinjësi të mirë me shtetet kufitare, përveç me Serbinë, e cila, sipas tij, ende nuk është e gatshme që të vendos marrëdhënie me Kosovën edhe pse kanë filluar bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Nga homologu i tij italian, kryetari i Kuvendit të Kosovës kërkoi ndihmë për njohjen e gjerë ndërkombëtare që i duhet Kosovës, sidomos në vendet ku Italia ka ndikim, dhe paraqiti pengesën që i vjen Kosovës nga mosnjohja prej të gjitha vendeve të

BE-së. Gjithashtu, z. Krasniqikërkoi nga shteti italian që të ushtrojë ndikimin e tij në trajtimin e Kosovës njësoj sikurse shtetet e tjera të rajonit në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në takimet rajonale e ndërkombëtare. Kërkoi mbështetje edhe në procesin e integritimit evropian, krijimin e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet BE-së dhe Kosovës, anëtarësimin e Kosovës në Unionin Ndërparlamentar, si dhe rikthimin e marrëveshjes për masat preferenciale tregtare. Nevojë tjetër që paraqiti në këtë takim kryetari Krasniqi, ishte edhe procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Duke folur për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Italisë, kreu legjislativit në mënyrë të veçantë foli për bashkëpunimin ndërmjet dy parlamenteve. Me qëllim të harmonizimit të legjislationit të Kosovës me standardet evropiane, ai shprehu nevojën për shpreshtimin e kontakteve dhe thellimit të marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve, nëpërmjet të shkëmbimit të vizitave nga ana e komisioneve parlamentare dhe të administratës,

nënshkrimit të një memorandumit ndërmjet të dy sekretarëve të parlamentareve për bashkëpunim administrativ etj.

Të dy kryetarët ranë dakord për formimin e grupeve parlamentare të miqësisë në të dy parlamentet dhe u dakorduan që rreth kësaj të fillojnë menjëherë procedurat.

Një tjetër çështje që z. Krasniqi ngriti në këtë takim, ishte edhe nevoja për shtimin e investimeve italiane në Kosovë, ku dita-ditës po krijohen kushte të favorshme për investime të huaja. U shtrua nevoja, gjithashtu, edhe për nënshkrimin e një sërë marrëveshjeve dypalëshe.

Në takim kryetari Krasniqi foli edhe për raportin e Dik Martit dhe për dëmet që ai i ka shkaktuar ai Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ai sqaroi pastërtinë e luftës çlirimtare në Kosovë dhe të pavërtetat e cekura në këtë raport, duke shprehur, njëkohësisht, gatishmërinë e institucioneve të Kosovës për një hetim të mirëfilltë rreth çështjeve të ngritura në këtë raport, në mënyrë që kjo çështje të mbyllet sa më parë që është e mundur.

Kryetari i Dhomës së Deputetëve të Parlamentit Italian, z. Gianfranco Fini, pasi i uroi mirëseardhje kryetarit Krasniqi dhe delegacionit që e shoqëronte, theksoi se në parlamentin italian ka pasur gjithmonë përkrahje për Kosovën. "Ne e kemi kontribuar në NATO dhe e kemi njohur Kosovën me një përkrahje shumë të gjerë në parlament", theksoi Fini. Ai vlerësoi se kjo vizitë është shumë e qëlluar dhe do t'i kontribuojë thellimit të marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve dhe vendeve tona. Gianfranco Fini theksoi se parlamenti i Italisë i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit të Kosovës me vendet e rajonit dhe në këtë rrafsh, ai vlerësoi rëndësinë e dialogut me Serbinë.

Duke folur për situatën që Kosova ka kaluar në gjashtëmujorin e fundit, ai theksoi se për Kosovën dhe institucionet e saj reformat janë më se të nevojshme, të cilat do të ndihmojnë në procesin e integritimeve evropiane.

Z. Fini, gjithashtu i interesua edhe për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Përveç pjesës zyrtare, pjesa tjetër e takimit u zhvillua në një drekë pune, gjatë të cilës u ngritën çështje të ndryshme.

Me qëllim të njohjes nga afër me zhvillimet dhe të arriturat në Kosovës, kryetari Krasniqi e ftoi z. Fini për një vizitë zyrtare në Kosovë, të cilën ai e pranoi me kënaqësi dhe shprehu gatishmërinë që këtë ta realizojë në një kohë të përshtatshme për të.

Zv/presidenti i Senatit italian, z. Vannino Chiti: "Momentet nëpër të cilat po kalon Kosova, më kujtojnë momentet e themelimit të Italisë"



Në kuadër të vizitës në Itali, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi dhe delegacioni që e shoqëron, u takua sot pasdite me zv/presidentin e Senatit italian, z. Vannino Chiti.

Duke e falënderuar zyrtarin e lartë italian për gjithë kontributin që Italia ka dhënë për Kosovën, kryetari Krasniqi e ka njoftuar atë me zhvillimet aktuale në Kosovë dhe të arriturat që

ajo ka pasur në vitet e fundit. Kreu i Kuvendit e ka njohur zv/presidentin e Senatit edhe me sfidat me të cilat po përballet shteti i Kosovës, duke potencuar në këtë rast problemet në veri të vendit. Kreu i legjislativit, gjithashtu, ka bërë një pasqyrim të punës dhe përbërjes së Kuvendit të Kosovës.

Edhe në këtë takim kryetari Krasniqi ka kërkuar ndihmën italiane në procesin e integ-

rimit evropian të Kosovës.

Zv/presidenti i Senatit, Vannino Chiti, duke i uruar mirëseardhje kryeparlamentarit Krasniqi dhe delegacionit që ai udhëheq, theksoi se momentet nëpër të cilat po kalon Kosova, kujtojnë momentet e themelimit të Italisë, që, sipas tij, kanë ngjashmëri shumë të madhe. Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, tha z. Chiti, është me rëndësi të madhe jo vetëm për Kosovën, por

edhe për Italinë dhe të gjitha shtetet e tjera anëtare të BE-së, por foli edhe për kushtet që duhet plotësuar në këtë proces.

Sa i përket liberalizimit të vizave, ai tha se edhe pse kjo është kompetencë e qeverisë, do të bisedojë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, në mënyrë që të krijohen kushte për të ndihmuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës.

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Stefano Stefani: Vizita në Itali - një mundësi e mirë për ndërtimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet parlamenteve.



Një pritje e veçantë, kryetari Krasniqi i ishte rezervuar nga kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, z. Stefano Stefani. Duke e falënderuar zyrtarin e lartë të parlamentit italian për pritjen dhe mbështetjen që Italia i ka dhënë Kosovës, kryetari Krasniqi e njoftoi atë me zhvillimet në Kosovë dhe të arriturat e saj. Kreu i Kuvendit foli për zgjedhjet e vitit të kaluar në Kosovë dhe konstituimin e institucioneve të dala nga këto zgjedhje, ndërsa vëmendje të veçantë iu kushtoi problemeve në veri të Kosovës dhe obstrukcioneve që Serbia i bën atje shtetit të Kosovës. Krasniqi, gjithashtu, dha një pasqyrë të punës dhe përbërjes së Kuvendit të Kosovës, veçanërisht të pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë dhe rolit të tyre.

Kryetari i Kuvendit potencoi synimet e institucioneve të Kosovës për përmbushjen sa më të shpejtë të kriterëve për liberalizimin e vizave, për integrimet euroatlantike dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, për të cilat i kërkoi z. Stafani mbështetjen e parlamentit italian.

Krasniqi foli për bisedimet që po zhvillohen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, njohjet e shtetit të Kosovës dhe lobimin për njohje të reja,

rreth të cilit kërkoi mbështetje nga mikpritësi. Duke folur rreth zhvillimit ekonomik të vendit, Krasniqi vuri theksin në mundësitë e investimeve italiane e të vendeve të tjera, duke pasur parasysh krijimin e kushteve për investitorë të huaj në Kosovë.

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Stefano Stefani, pasi i shprehu mirëseardhje delegacionit të Kosovës, theksoi se kjo vizitë është një mundësi e mirë për ndërtimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet parlamenteve të të dyja vendeve. Ai tha se për Italinë, Kosova është një vend mik dhe se përsheptimi i procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe integrimi evropian i saj, është interes jo vetëm i Kosovës dhe i Italisë, por i të gjitha vendeve të BE-së.

Sa i përket njohjeve të shtetit të Kosovës, Stefani tha se këto varen nga dialogu me Serbinë dhe rezultatet që do të dalin nga ky dialog, të cilin ai e cilësoi si shumë të rëndësishëm. Ai potencoi interesimin e Italisë edhe për mbrojtjen e monumenteve fetare e kulturore në Kosovë, për të cilën kryetari Krasniqi dha sqarimet e nevojshme, duke potencuar tolerancën fetare në Kosovë.

KRASNIQI KËRKON NJOHJEN E KOSOVËS NGA VATIKANI



Kryetari Krasniqi, zhvilloi një takim të veçantë në Vatikan me Monsinjur Jagodzinski, zyrtar i lartë i Vatikanit, të cilin e njoftoi me të gjitha të arriturat në Kosovë. Gjatë këtij takimi, kërkesë e veçantë e kryetarit Krasniqi ishte njohja e Republikës së Kosovës nga ana e Vatikanit.

Jagodzinski, nga ana e tij, theksoi se është shtuar vëmendja për Kosovën dhe se kjo dëshmohet edhe me emërimin e delegatit apostolik për Kosovën nga Selia e Shenjtë. Ai theksoi, gjithashtu, se Vatikani i përcjell me vëmendje zhvillimet në Kosovë dhe shpreh hu kënaqësinë për arritjet e saj.

TRI PYETJE PËR KRYETARËT E GRUPEVE PARLAMENTARE

Adem Grabovci kryetar i Gr. Parlamentar të PDK -së



1- Cilat janë objektivat e partisë tuaj këtë legjislaturë?

Unifikimi ,koordinimi në mes të Qeverisë Kuvendit dhe Grupeve Parlamentare, konstruktivitetit i grupit, angazhimi dhe mobilizimi i tërë potencialit të Grupit Parlamentar për të dhënë kontributin në funksionalizimin e institucioneve te vendit me të gjitha instruksionet.

2- Cili është vlerësimi juaj për bisedimet Kosovë – Serbi dhe për rezolutën e Kuvendit?

Çdo nisëm e cila vlerësohet se është në të mirë të vendit, stabilitetit, sigurisë dhe hapjes së perspektivës të Kosovës dhe popullit të saj ne e kemi përkrah dhe do të vazhdojmë në angazhimin dhe dhënien e kontributit tonë. I mbështesim bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë si dy shteteve të pavarura dhe sovraane, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin. Agjenda e dialogut do të përfshij vetëm çështjet teknike të interesit të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës.

3. Prioritetet tuaja për zhvillimin e Kosovës

Angazhimin dhe dhënien e kontributit përmes komisioneve parlamentare, zhvillimin ekonomik, rritja e shkallës së stabilitetit në vend, hapja e rrugës si dhe për përsheptimin e integriteteve evropiane dhe euroatlantike siç janë anëtarësimi i vendit tonë në BE dhe NATO

Ismet Beqiri kryetar i Gr. Parlamentar të LDK -së

1- Cilat janë objektivat e partisë tuaj këtë legjislaturë?

Lidhja Demokratike e Kosovës, si parti e vlerave dhe traditës, me angazhimin e saj shumëvjeçar në shtete formimin e Kosovës, padyshim ka dhënë dhe do të jap kontributin e saj edhe në shtet ndërtimin e Kosovës, tani si parti politike opozitare nr. 1 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Angazhimi yni prioritar në këtë legjislature do të jetë: -Kontributi ynë maksimal profesional dhe politik në nxjerrjen, miratimin e ligjeve sa më përmbajtësore, profesionale dhe të implementueshme.

Po ashtu nxjerrja e ligjeve që janë në interes të qytetarëve të Kosovës,

Pengimi ynë me të gjitha mjetet ligjore që mos lejo-

jmë asnjë veprim ligjor dhe , jo ligjor, që do të ishte në dëm të krijimit të infrastrukturës së mirëfilltë ligjore, konformë aktit tonë më të lartë shtetëror, Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare .

LDK-ja dhe Grupi Parlamentar i saj, si gjithmonë, me nivelin e lartë intelektual, politik dhe profesional të tyre, me konstruktivitetin e tyre, si Parti dhe si Grupi Parlamentar, do të jenë në shërbim të funksionimit të Parlamentit si Institucioni më i Lartë Ligjvënës.

LDK-ja, Grupi ynë Parlamentar do të jenë gjithmonë të vëmendshëm, kritik dhe të vendosur që me qëndrimet e qarta të pamundësojmë çdo veprim që do të ishte në dëm të qytetarëve tanë dhe shtetit tonë.

2- Cili është vlerësimi juaj për bisedimet Kosovë – Serbi dhe për rezolutën e Kuvendit?

Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka thënë qartë dhe në mënyrë të vazhdueshme se:

-Bisedimet me Serbinë, janë duke u bërë me shumë mangësi nga ana jonë.

-Bisedime pa platformë të artë të asaj, se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të bisedohet.

-Jo bisedime të nivelit të pabarabartë. E vendosim theksin këtu, se nëse Beogradi dërgon për bisedime një , qatip, zyrtar të nivelit të ulët, pse ne duhet të angazhohjmë në krye të bisedimeve një zyrtar të lartë, njeriun e dytë në Qeveri.

- Bisedimet janë të papërgatitura mirë. Ka tema për të cilat me Serbinë nuk do të duhej të bisedohej si p.sh, kthimi i personave të pagjetur. Ne jemi të bindur se ata e dinë, se ku ndodhen trupat e tyre, sepse vetë i kanë bërë ato krime, njerëz që edhe sot janë pjesë e institucioneve të Serbisë.

-Nuk ka çka të bisedohet për eliminimin e strukturave ilegale serbe që veprojnë jo vetëm në veriun

e Kosovës por edhe në pjesët tjera të saj, këtu duhet vullnet dhe përkrahje më e madhe politike edhe e bashkësisë ndërkombëtare, ato thjesht duhet të pamundësohen të veprojnë, të arrestohen kriminelët e tillë dhe Serbia duhet të ballafaqohet me presion ndërkombëtar, që ta ndërpresë krijimin, përkrahjen logjistike dhe financiare të këtyre strukturave ilegale, Ne si LDK kemi qenë dhe jemi për dialog, bisedime, por si palë të barabarta, për çështjet që mund të bisedohen, për bisedime transparente dhe mbi të gjitha për çdo marrëveshje eventuale me Serbinë, të vendoset në Kuvend të Republikës së Kosovës, pra ajo duhet të ratifikohet me 2/3 e votave të Deputetëve të Kuvendit dhe çdo anashkalim i Kuvendit për LDK-në do të jetë e papranueshme.

Kjo ka qenë një ndër arsytet e shumta pse LDK-ja nuk ka votuar për Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për bisedimet Kosovë-Serbi.

Shkurt e thënë, ne jemi skeptik për rezultatin e këtyre bisedimeve. Të shohim.



3. Prioritetet tuaja për zhvillimin e Kosovës

Lidhja Demokratike e Kosovës, si parti e qendrës së Djathtë, në programin e saj në mes të tjerash ka programin dhe synimet e veta për zhvillimin e Kosovës. Duke pasur parasysh faktin se jemi parti opozitare, sigurisht që synimet tona është vështirë ti realizojmë, por angazhimet tona do të ishin për:

-Zhvillimin ekonomik të vendit, ekonomisë së lirë të tregut, krijimit të vendeve të lira të punës,

-Krijimin e parakushteve për ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë,

-Krijimin e sigurisë ligjore, të sigurisë dhe lehtësira për diçka të tillë,

-Sundimin e rendit dhe ligjit , luftimi i korrupsionit dhe ekonomisë informale,

-Arsim më kualitativ,

-shërbime shëndetësore më efikase,

-krijim të hapësirës më të madhe për të rinj,

-Vëmendje e posaçme zhvillimit të Kulturës, sportit etj.

Të gjitha ato që u thanë me lartë konsiderojmë se nuk janë në rrugën e drejtë nga të qeverisurit aktual.

sepse:

Nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka investime të huaja, nuk ka raporte të mira me Institucionet ndërkombëtare, veçmas ato financiare, nuk ka transparencë në proceset e caktuara në vend si:bisedimet me Serbinë, procesi i privatizimit, luftimi i korrupsionit, mungesa e shtrirjes së sovranitetit në tërë territorin e Kosovës etj.

Kurse shumicën e këtyre synimeve, prioriteteve, LDK-ja me sukses po i realizon atje ku është në pozitë, në nivel lokal, në disa Komuna, duke filluar nga puna e madhe që po bëhet në kryeqytet, por edhe në disa komuna të tjera.

Sigurisht që kontributi ynë do të jetë për aq sa do të jetë hapësira e lirë e veprimit, kjo kuptohet se në opozitë është e vështirë, por padyshim do të jemi vrojtues, mbikqyrës, të proceseve dhe zhvillimeve në vend dhe do të reagojmë për të gjitha ato zhvillime që janë në dëm të ndërtimit dhe zhvillimit të shtetit të Kosovës.

Padyshim që këto synime tona do të vijnë në shprehje pasi të kthehemi si parti e parë në pushtet.

Visar Ymeri kryetar i Gr. Parlamentar të Lëvizjes Vetvendosje

1- Cilat janë objektivat e partisë tuaj këtë legjislaturë?

Lëvizja VETËVENDOSJE! është lëvizje politike, të tillë janë edhe deputetët e saj në Kuvend. Për ne demokracia nuk është thjeshtë çështje e respektimit të procedurave. Ajo është në radhë të parë çështje e vullnetit kolektiv. Duke qenë kështu, Kuvendi i Kosovës për t'i qëndruar detyrës duhet t'i ndërrohet karakteri. Kuvendi është tribuna ku flitet politikisht, por mbi të gjitha ai është organi më i lartë vendim-marrës. Për secilën çështje të rëndësishme që nuk vendosin qytetarët me referendum, fjalën e fundit

e ka Kuvendi. Duke i munguar këto cilësi Kuvendi është bërë legjitimues i vendimeve arbitrare të Qeverisë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është votuar nga qytetarët e Kosovës për ta mbrojtur një koncept dhe program politik. Prandaj, edhe deputeti i Lëvizjes VETËVENDOSJE! ka detyrime ndaj dy gjërave: konceptit politik dhe mbrojtjes së interesave të qytetarëve përmes këtij koncepti.



2- Cili është vlerësimi juaj për bisedimet Kosovë – Serbi dhe për rezolutën e Kuvendit?

Për Lëvizjen VETËVENDOSJE! procesi i bisedimeve me Serbinë është jo legjitim, i dëmshëm, prandaj i papranueshëm. Jo legjitim, sepse bëhet fjalë për bisedime me një shtet jo dosido. Bëhet fjalë për shtetin e Serbisë me gjithë bagazhin negativ që ka ky shtet ndaj Kosovës historikisht, aktualisht dhe potencialisht edhe në të ardhmen. Për një proces të tillë ne mendojmë se duhen pyetur qytetarët përmes referendumit, ndërkohë që bisedimet kanë filluar madje edhe pa lejen e Kuvendit. Rezoluta e miratuar a posteriori më parë se sa ta legjitimoj procesin ia ka zbehur tej mase rolin Kuvendit.

Ne në Lëvizjen VETËVENDOSJE! jemi të bindur se nuk duhet pasur kurrfarë bisedimesh me Serbinë në rrethanat aktuale. Në vijim po i tregoj arsytet pse Lëvizja VETËVENDOSJE! mendon se nuk duhet biseduar me Serbinë:

- Serbia nuk e pranon pavarësinë e Kosovës;
- Serbia nuk po e ndryshon kushtetutën e saj ku shkruan që Kosova është pjesë e Serbisë;
- Serbia nuk i ka kërkuar falje Kosovës për krimet ndaj shqiptarëve përgjatë gjithë shekullit XX;
- Serbia nuk na i ka dorëzuar kriminelët serbë të

luftës;

- Serbia nuk na i ka kthyer trupat e rreth 1800 të pagjeturve dhe nuk jep informacione për ta;
- Serbia nuk na i ka paguar dëmet e luftës dhe okupimit;
- Serbia ua shkel të drejtat shqiptarëve autoktonë në Luginën e Preshevës dhe i shtyp ata;
- Serbia vazhdon t'i financojë strukturat e saj ilegale në Kosovë;
- Serbia nuk na e ka kthyer fondin pensional, depozitat bankare të qytetarëve të Kosovës dhe librat kadas-tralë;
- Në Serbi janë dhjetëra mijëra kriminelë serbë të luftërave të viteve të '90-ta që shëtisin të lirë e të pacenuar.

Përveç këtyre arsyeve, këto bisedime do të prodhojnë rezultate të dëmshme për Kosovën sepse janë asimetrike; nuk bisedohet midis Kosovës dhe Serbisë për Serbinë dhe Kosovën, por vetëm për Kosovën. Kosova është objekt negociatash. Gjithashtu faktorët ndërkombëtarë që ndërmjetësojnë në bisedime, sundojnë me Kosovën, por jo edhe me Serbinë.

3- Cilat janë prioritetet tuaja për zhvillimin e Kosovës

Programi i Lëvizjes VETËVENDOSJE! mban emrin "Zhvillim dhe Shtetndërtim". Për një Kosovë prosperuese për qytetarët e saj, duhet sovranitet dhe integritet territorial në njërën anë, dhe kontroll i resurseve natyrore e kapaciteteve zhvillimore në anën tjetër. Ne synojmë mbrojtjen dhe përkrahjen e prodhimit

vendor, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, industrializimin e vendit, integrim të tregut mbarë shqiptar, integrim të sistemit energjetik të Kosovës me Shqipërinë, dhe masa reciprociteti me shtetet që ndalojnë eksportet tona.

U MBAJT TRYEZA PËR STRATEGJINË LEGJISLATIVE 2011

Strategjia Legjislative e Qeverisë, për vitin 2011, përmban 148 projekt-ligje



NDI - Kryetarët e Grupeve Parlamentare dhe administrata

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) dhe Shërbimi për Hulumtime Parlamentare në Kuvendin e Kosovës, në bashkëpunim me Institutin GAP dhe Institutin e Kosovës për Drejtësi, kanë mbajtur një tryezë diskutimi me temë: Strategjia legjislative 2011. Në këtë takim përveç përfaqësuesve të NDI-së, GAP-it dhe IKD-së, morën pjesë edhe kryetarët të komisioneve parlamentare dhe deputetët të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të Qeverisë, përfaqësues të Administratës së Kuvendit të Kosovës, si dhe nga shoqëria civile.

Strategjia Legjislative e Qeverisë, për vitin 2011, përmban 148 projekt-ligje. Kjo Strategji Legjislative e mbingarkuar do të krijojë vështirësi në punën e Kuvendit.

Nga përvoja e deritashme, Kuvendi me vështirësi ka arritur që ta realizojë vetëm gjysmën e kësaj strategjie, pikërisht për shkak të numrit të madh të projekt-ligjeve, mungesës së kordinimit dhe bashkëpunimit të të gjithë akterëve të përfshirë në procesin legjislativ, si dhe për shkak të mungesës së përfshirjes së hulumtimeve dhe ekspertizës gjatë përpilimit dhe shqyrtimit të ligjeve në nivel qeveritar dhe parlamentar. Për më shumë, kanë kaluar katër muaj dhe kemi vetëm një ligj të miratuar, u tha gjatë këtij takimi nga organizatorë të kësaj tryeze.

Gjatë këtij takimi përveç diskutimit rreth hulumtimit të bërë nga GAP-i, pjesëmarrësit kanë diskutuar edhe për aspektin e transparencës në ligjbërje, si në nivelin e Qeverisë, po ashtu edhe të Kuvendit të Kosovës, për faktin se si mund të kemi një agjendë legjislative, në mënyrë që të jetë sa më e realizueshme dhe se çfarë mund të bëhet në të ardhmen në mënyrë që agjenda legjislative të jetë më pak e ngarkuar dhe më shumë e realizuar, u tha gjatë këtij takimi.

Në këtë tryezë u prezantua hulumtimi i GAP-it, nga ana e përfaqësuesve të këtij instituti, si dhe numri i projektligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës që nga viti 2008.

U tha se pas këtij debati draft-analiza do të pasurohet me rekomandime shtesë që do të dalin nga ky takim dhe kjo do t'iu dërgohet të gjitha institucioneve të vendit. Në vijim të takimit u tha se ka nevojë për një transparencë më të madhe gjatë hartimit, diskutimit dhe miratimit të projektligjeve. Ndërsa, u kritikua edhe cilësia e projektligjeve dhe ligjeve.

Kryetarët e komisioneve parlamentare gjatë këtij takimi kanë shpalosur në detaje punën dhe angazhimet e komisioneve që përfaqësojnë ata.



NDI - Kryetaret e Grupeve Parlamentare dhe administrata

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj tha se strategjia legislative është mjaft e ngjeshur. Ajo tha se komisioni të cilin e përfaqëson ajo, gjatë këtij viti duhet t'i shqyrtojë dy ligje për Buxhetin, atë për vitin 2011, si dhe atë për vitin 2012. "Në këtë komision kalojnë të gjitha ligjet që miratohen në Parlamentin e Kosovës, për të shqyrtuar implikimet buxhetore", sqaroi Hadërgjonaj, duke shtuar se këtë komision e pret një punë voluminoze, e cila duhet të shoqërohet me profesionalizëm.

Duke folur rreth planit të punës së Komisionit për Buxhet përgjatë këtij viti ajo tha se ekziston nevoja që të ketë më shumë ekspertizë ndërkombëtare dhe vendore në mënyrë që këto ligje të dalin sa më cilësore.

Deputetët gjatë diskutimet të tyre mohuan faktin se nuk ka transparencë tek miratimi i ligjeve, meqë çdokush mund të marrë pjesë në dëgjimet publike dhe t'i drejtohet Kuvendit me rekomandime për amendamente të caktuara.

Deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi, nënkryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, tha se nuk duhet të mohohet fakti se ka progres evident edhe në pikëpamje sasiore edhe në pikëpamje të cilësisë. Vërejtje rreth strategjisë ai dha tek mungesa e prioritetizimit të ligjvënies. Më tej ai shtoi se nuk mund të jemi të kënaqur me sas-

inë, sepse një pjesë e ligjeve që numërohet në statistika janë për shkak të ndryshuar preambulën për shkak të ndryshimit të Kushtetutës dhe kjo nuk na bënë që të mburremi me këtë. Hyseni tha se në të gjitha ligjet ka pasur një ekspertizë ndërkombëtare, që më vonë ka ardhur një ekspertizë tjetër ndërkombëtare. "As standardet ndërkombëtare nuk janë të standardizuara".

Anëtari i Komisionit për Legjislacion dhe kryetar i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës, deputeti Armend Zemaj theksoi se raporti mes Qeverisë dhe Kuvendit, si dhe me shoqërinë civile, në rrafshin ligjor, nuk ka munguar. Zemaj tha se asnjë ligj nuk është punuar pa bashkëpunimin e sponsoruesit të ligjit dhe të shoqërisë civile. Zemaj shtoi se në këtë legjislaturë ka disiplinë dhe vullnet më të madh në punën e komisioneve funksionale, andaj sipas tij rezultatet nuk do të mungojnë.

Përfaqësuesit e Qeverisë theksuan se bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës dhe komisionet parlamentare është shumë i mirë, duke shprehur besimin se do të arrihet të realizohet në përpikëri kjo strategji. Në këtë takim kontribuan me diskutimet e tyre edhe deputetët Suzan Novobrđaliu, Nait Hasani, Xhevahire Izmaku, Time Kadriaj, etj.

KOMISIONI PËR PUNË TË JASHTME INICION: MARRVËVESHJE MES KOSOVËS E SHQIPËRISË PËR PERFAQËSIM RECIPROK



Komisioni për Punë të Jashtme

Në mbledhjen e datës 27.04.2011e Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Albin Kurti, kryetar, në fillim u njoftua për kërkesën e anëtarit të komisionit z. Shaip Muja, që ka të bëjë me mbledhjen e 8 prillit, ku ishte ftuar edhe zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri, për të informuar Komisionin për bisedimet Kosovë-Serbi.

Z. Muja këtë kërkesë e vlerëson si një ftesë paragjykuese dhe se me këtë z. Albin Kurti keqpërdor pozicionin e tij, që ia lejon Rregullorja e Kuvendit të Kosovës. Po kështu, në letër i bëhen vërejtje edhe sekretarisë së Kuvendit e cila nuk ka reaguar rreth një komunikimi të këtillë.

Z. Albin Kurti mohoi se ka keqpërdorur pozitën, dhe se në këtë komunikim ka ndonjë faj sekretaria. Pas ballafaqimit të mendimeve e qëndrimeve ndërmjet z. Kurti dhe z. Muja, që shoqëroheshin edhe me kundërpërgjigje, në debat u përfshinë edhe një pjesë e anëtarëve të Komisionit, të cilët u angazhuan për krijimin e një klime të mirë në punën e Komisionit, duke theksuar se ashtu sikurse në Ministrinë e Punëve të Jashtme bëhen përpjekje për qëndrime konsensuale edhe në këtë Komision duhet të mbretërojë një politikë e tillë. Për të krijuar një klimë të favorshme pune është e nevojshme që anëtarët e Komisionit të angazhohen për zbatim të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, theksonin diskutuesit.

Në vijim Komisioni kishte në rendin e ditës

diskutimin për iniciimin e një marrëveshjeje mes Kosovës e Shqipërisë për përfaqësim reciprok.

Moto e diskutimeve të anëtarëve të Komisionit rreth kësaj çështjeje ishte domosdoshmëria e një angazhimi shumë më të madh të Kosovës për njohje të reja nga shtete që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e vendit, deri në anëtarësimin e Kosovës në OKB. Në këtë kontekst angazhimi i Shqipërisë është dhe do të jetë me rëndësi të veçantë. Ndërkaq, kur është fjala për praktikën e përfaqësimit të një shteti nga një shtet tjetër, ashtu si dhe përfaqësimi i përbashkët, u tha se kjo është e njohur në relacionet ndërkombëtare. Në këtë vështrim Shqipëria do të përfaqësonte Kosovën atje ku kjo nuk ka ambasada, por njëkohësisht do ta përfaqësonte edhe në institucione ndërkombëtare, në të cilat Kosova ende nuk është anëtarësuar. U përmend edhe praktika e misioneve të përbashkëta, siç është rasti i Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar, që do të mund të aplikohet edhe nga ana e Kosovës dhe e Shqipërisë. U tha se baza ligjore për bashkëpunim të këtillë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ekziston, por ajo mund të avancohet edhe më.

Në përmbyllje të debatit, anëtarët e Komisionit u pajtuan që t' i rekomandohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për ta përfshirë në strategjinë e saj të punës edhe marrëveshjen me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë për përfaqësim reciprok ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

KRIJOHET KOMISIONI PËR NDRYSHIME KUSHTETUESE



Komisioni për ndryshimet Kushtetuese

Komisioni për Ndryshime Kushtetuese i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhjen konstituive, nën kryesimin e deputetit Dr. Arsim Bajrami, kryetar i komisionit.

Para përfaqësuesve të të gjitha grupeve parlamentare, kryetari Bajrami foli për punën e Komisionit dhe detyrat që i presin anëtarët e tij brenda periudhës nëntëmuajore, për ndryshimin e Kushtetutës. Bajrami ofroi bashkëpunimin e tij në cilësinë e kryetarit dhe njëkohësisht kërkoi përkrahjen e anëtarëve të tjerë të komisionit, duke potencuar nevojën që qasja ndaj këtij procesi të jetë profesionale dhe me përgjegjësi politike.

Ai tha se aktualisht, komisioni ka mandat ligjor për të punuar në dy segmente: në amendamentimin e pjesës që ka të bëjë me zgjedhjen e presidentit, në mënyrë që të hapet rruga për zgjedhjen e drejtpërdrejt të tij, dhe në pjesën që ka të bëjë me zgjedhjet.

“Këto janë ndryshime substanciale dhe prekin bazat e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës, sepse një president i zgjedhur nga populli, ndikon edhe në kualitetin e qeverisjes”, theksoi kryetari Bajrami. Por, sipas tij, komisioni do të kërkojë mandat shtesë nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës edhe në segmente të tjera, veçanërisht në kaptinën e tranzicionit, në të cilën janë paraparë kompetencat e prezencës civile ndërkombëtare, në një periudhë të parë të pavarësisë.

Sipas tij, ka mundësi që shumë kompetenca,

të cilat aktualisht janë duke u ushtruar nga prezencat ndërkombëtare, të barten tek institucionet vendore.

Por, ai tha se për këtë çështje duhet konsensus i brendshëm dhe me faktorin ndërkombëtar. Sipas tij, i gjithë ky proces do të zhvillohet në konsultim të ngushtë me mekanizmat ndërkombëtarë, duke marrë edhe shembuj të mirë nga vendet që e kanë kaluar këtë fazë tranzicionale.

Bajrami tha se procesi do të zhvillohet në tri faza: faza e parë do të përfshijë debatet profesionale, në fazën e dytë do të bëhet draftimi dhe në fazën e tretë ndryshimet do t'i nënshtrohen debatit publik.

Ai tha se krahas ndryshimeve kushtetuese, në mandat të komisionit është edhe draftimi i një ligji për zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit.

Kryetari Bajrami bëri të ditur se në javën e ardhshme do të paraqitet në komision plani i punës së komisionit, në të cilën do të përcaktohet agjenda e punës.

Edhe anëtarët e tjerë të komisionit folën për nevojën e ndryshimeve në Kushtetutë, duke potencuar edhe rëndësinë e këtyre ndryshimeve, të cilat, siç thanë ata, do të kenë implikime edhe në pjesë të tjera të saj. U potencua domosdoshmëria që, pas ndryshimeve, Kushtetuta të jetë e zbatueshme. Deputetët shfaqën qëndrimin që gjatë këtij procesi, komisioni ta kryej punën e vet në mënyrë kualitative.

OSBE-JA I DHUROI NJË FOND LIBRASH DHE DISA PUNIME HULUMTUESE BIBLIOTEKËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS

OSBE-ja partner mbështetës në vazhdimësi i Kuvendit të Kosovës



OSBE - Deputetet dhe Sekretari i përhershëm i Kuvendit të Kosovës

Në ambientet e Bibliotekës së Kuvendit të Kosovës, u organizua një ceremoni me rastin e dhurimit të një donacioni (fond librash) për bibliotekën. Përveç 100 librave të dhuruar me këtë rast u dorëzuan edhe disa punime hulumtuese. Ceremoninë e hapi sekretari i përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, z. Ismet Krasniqi, ndërsa ishin të pranishëm edhe drejtorja e Departamentit për Demokratizim në Misionin e OSBE-së, në Kosovë, Wilma Theuws dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Duke e falënderuar OSBE-në për dhurimin e këtij fondi të librave, z. Ismet Krasniqi, shprehu njëkohësisht mirënjohje për Misionin e OSBE-së për ndihmën në vazhdimësi që i ofron Kuvendit të Kosovës. OSBE-ja, theksoi Krasniqi, është bërë partner mbështetës në kontinuitet i Kuvendit të Kosovës. Në emër të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për

këtë dhe ndihma të tjera të çmuara nga ana e OSBE-së, u falënderua edhe deputeti Hydajet Hyseni. Ai tha se kjo ndihmë po vjen në kohën e duhur, sepse na është e nevojshme edhe përvoja që del nga këto libra dhe punime hulumtuese në fushën e legjislacionit.

Duke iu drejtuar të pranishmëve, znj. Wilma Theuws, tha se është nder për të që gjendet në këtë ceremoni dhurimi të librave. Cilësia e ligjeve, theksoi ajo në vazhdim, është bazë e demokracisë. Në këtë vështrim, me rastin e hartimit të ligjeve kjo literaturë do të ndihmojë shumë ligjvënësit. Ajo u falënderua edhe për bashkëpunimin që ka Kuvendi i Kosovës me OSBE-në në shumë fusha, ndërkohë shprehu gatishmërinë e OSBE-së se edhe më tutje me përkushtim të ndihmojë Kuvendin e Kosovës.

Takimet e kryetarit

Gjermania partnere strategjike e Kosovës



Krasniqi - Niebel

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti një delegacion të Republikës Federale të Gjermanisë, i kryesuar nga z. Dirk Niebel, ministër për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Në takim është biseduar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Kryeparlamentari Krasniqi i ka vlerësuar të shkëlqyeshme marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe e ka falënderuar shtetin gjerman për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës. Ai e ka quajtur Gjermaninë partnere strategjike të Kosovës, prandaj ka kërkuar nga qeveria e vendit mik dhe ministri Niebel, të angazhohen për njohjen e Kosovës edhe nga pesë vendet e mbetura të BE-së, si dhe për mbështetje në procesin e liberalizimit të vizave dhe për anëtarësimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike. Krasniqi ka folur, ndërkaq, edhe për përbërjen e legjis-

laturës së re të Kuvendit të Kosovës. Ministri gjerman për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Dirk Niebel, duke e falënderuar kreun e Kuvendit të Kosovës për pritjen, është shprehur i kënaqur me numrin e ligjeve të miratuara nga legjislativi i vendit. Ai ka vlerësuar rëndësinë që kanë për vendin miratimi i ligjeve cilësore, si dhe kontrolli i zbatimit të tyre. Niebel ka pohuar se Gjermania po bën përpjekje që Kosovën ta njohin të gjitha vendet e BE-së. Zgjidhja e kësaj çështjeje, ka thënë ministri gjerman, do ta lehtësojë procesin e liberalizimit të vizave ndërmjet Kosovës dhe vendeve të BE-së, si dhe do ta ndihmojë procesin e integritimit të Kosovës në strukturat euro-atlantike.

Të dy bashkëbiseduesit janë pajtuar se ka vend për thellimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve të mira ndërmjet dy vendeve.

Kuvendit të Kosovës i duhet përvoja dhe ndihma e shteteve me traditë më të gjatë demokratike

Kryeparlamentari Krasniqi dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, i kryesuar nga Safete Hadërgjonaj - Takim i përbashkët me delegacionin e Republikës Federale të Gjermanisë



Nga takimi dy palësh

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, i kryesuar nga Safete Hadërgjonaj, kanë zhvilluar një takim të përbashkët me delegacionin e Republikës Federale të Gjermanisë, të kryesuar nga z. Dirk Niebel, ministër për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Gjatë takimit, u diskutua gjerësisht për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve dhe parlamenteve, si dhe mundësisë së thellimit të tij në të ardhmen.

Duke i potencuar të arriturat në Kuvendin e Kosovës, kreu i legjislavit identifikoi edhe disa objektiva këtij institucioni, me theks të veçantë, mbikëqyrjen e institucioneve nga ana e Kuvendit dhe zbatimin e ligjeve, për të cilat tha se nevojitet ndihma dhe përvoja e vendeve me traditë më të gjatë demokratike. Përkritazi me këtë, ai shtroi nevojën për vazhdimin e ndihmës nga ana e shtetit gjerman. Ministri gjerman për Zhvillim Ekonomik, Dirk Niebel, bazuar në përvojën e tij parlamentare gjermane, foli për rëndësinë e parlamentit dhe në veçanti, të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ai theksoi se një nga detyrat kryesore të këtij komisioni duhet të jetë kontrolli ndaj qeverisë dhe dërgimi i parave të taksapaguesve në vendin e duhur. Ai theksoi se është me rëndësi të madhe që vendi të ketë një parlament të aftë, si bazë për integrim në BE. Duke shfaqur vullnetin e qeverisë

së tij për ta ndihmuar Kosovën në kalimin e tranzicionit dhe integrimin në BE, potencoi edhe rolin thelbësor që duhet ta ketë parlamenti në këtë proces.

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, Safete Hadërgjonaj, bëri një pasqyrim të punës dhe funksionimit të këtij komisioni, duke potencuar angazhimet kryesore të tij, si: nxjerrja e një legjislacioni me kosto të përlogaritur mirë dhe të përballueshme për buxhetin, si dhe krijimi i një ambienti sa më të volitshëm për zhvillimin e biznesit. Ajo foli gjerësisht për mbështetjen që komisionit i jep organizata gjermane GIZ, që nga viti 2009, në kompletimin e legjislacionit sipas standardeve të Bashkimit Evropian, gjetjen e ekspertëve, trajnimin e stafit etj.

Zëvendëskryetari i parë i komisionit, Naser Osmani, gjithashtu, potencoi nevojën e vazhimit të ndihmës nga GIZ-i, duke pasur parasysh natyrën specifike të punës së këtij komisioni dhe fazën në të cilën gjendet Kosova sa i përket hartimit të legjislacionit. Ai foli për përkrahjen profesionale që i duhet komisionit, veçanërisht kur bëhet fjalë për disa ligje të natyrës së financave dhe të ekonomisë.

Gjatë takimit, anëtarë të delegacionit gjerman u interesuan për çështje të ndryshme që lidhen me punën e komisionit dhe të Kuvendit në përgjithësi.

Dita e Evropës në Kosovë



Me rastin e Ditës së Evropës, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, është mbajtur një ceremoni zyrtare, në të cilën, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka mbajtur një fjalë rasti.

Kreu i Kuvendit, duke vënë në spikamë përpjekjet e gjata të popullit të Kosovës për integrimin e tij në Evropën e Bashkuar tha: -” Sot na ka bashkuar këtu një ditë dhe kremte e rëndësishme, dita e kontinentit tonë, Dita e Evropës së Bashkuar. Ne kemi arsye të shënojmë këtë ditë, jo vetëm pse Kosova i përket Evropës gjeografikisht dhe kulturalisht që nga antika, jo vetëm pse Evropa është këtu prezent, duke ndihmuar proceset demokratike, sigurinë dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm, por edhe për aspiratën e madhe dhe

shumë të sinqertë që ka vendi dhe populli ynë për t’u integruar në Bashkimin Evropian”.

Në vijim të fjalës së tij, kryeparlamentari Krasniqi edhe me këtë rast u bëri thirrje pesë shteteve, anëtare të BE-së që ta njohin Pavarësinë e Republikës së Kosovës.

“U bëj thirrje sërish këtyre pesë vendeve mike, Spanjës, Greqisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Qipros, që në emër të miqësisë midis tyre dhe vendit tonë, në emër të miqësisë midis popujve tanë, në emër të drejtësisë së konfirmuar ndërkombëtare për pavarësinë e Kosovës, në emër të paqes e të Evropës së Bashkuar, ta njohin Republikën e Kosovës dhe zgjidhjen e statusit të saj si një rast sui generis, i cili tash tri vite, ka qenë faktor stabiliteti dhe paqeje në rajonin tonë”, tha kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi.

Kosova do ta ketë mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për të ardhmen evropiane të saj.



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur të dërguarin special të Bashkimit Evropian për Kosovë, z. Fernando Gentilini. Pasi e ka uruar z. Gentilini për detyrën e re në Kosovë, e ka njoftuar atë për të arriturat në Kosovë dhe ka bërë një ekspozitë të punës së Kuvendit. Kreu i legjislativit ka folur për procesin e integrimit evropian të Kosovës, si e vetmja rrugë për shtetin e Kosovës, si dhe ka potencuar nevojën për liberalizimin e vizave.

Mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha vendet e BE-së, Krasniqi e ka cilësuar si pengesë në rrugën e integrimit euro-atlantik të vendit.

Kryetari i Kuvendit e vuri theksin edhe te problemet që Kosova ka në veriun e saj dhe mbështetjen që Beogradi

i jep atje krimit të organizuar. Përkitazi me këtë, Krasniqi vuri në dukje vendosmërinë e institucioneve të vendit për ta luftuar krimin në të gjithë hapësirën e Kosovës.

Gjatë takimit u fol edhe rreth dialogut teknik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, nga i cili, siç u tha, duhet të rezultojnë zgjidhje evropiane.

I dërguari special i BE-së Kosovë, Gentilini, e falënderoi kryetarin Krasniqi për pritjen dhe e përgëzoi atë për punën që është bërë në Kuvendin e Kosovës. Ai theksoi se Kosova do ta ketë mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për të ardhmen evropiane të saj, duke potencuar, gjithashtu, se edhe liberalizimi i vizave është në agjendën e BE-së.

Kryekuvendari Krasniqi priti ambasadorin e ri të Republikës së Çekisë në Prishtinë, z. Jiri Dolezel



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim njohës ambasadorin e ri të Republikës së Çekisë në Prishtinë, z. Jiri Dolezel. Me këtë rast kryekuvendari Krasniqi përgëzoi ambasadorin për detyrën e re, duke i uruar njëkohësisht edhe punë të mbarë.

Ambasadori z. Jiri Dolezel u falënderua për këtë pritje, ndërsa shprehu edhe angazhimin e tij për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet Çekisë dhe Kosovës. Bashkëbiseduesit kishin vlerësim të njëjtë se bashkëpunimi ndërmjet dy parlamenteve e shteteve respektive është gjithnjë e më i mirë.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, priti Grupin e Miqësisë Francë-Kosovë

U theksua domosdoshmëria e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës nëpër vendet e BE-së. Ishte interesim i dyanshëm që me ftesë të Senatit francez, një delegacion i Kuvendit të Kosovës, në të ardhmen, të vizitojë Francën.

Nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sabri Hamiti, i shoqëruar nga deputetët Donika Kadaj – Bujupi e Hydajet Hyseni, ka pritur në takim Grupin e Miqësisë Francë-Kosovë, të kryesuar nga zonja Marie-Therese Bruguiere, në përbërje të të cilit ishin edhe z. Jean-François Humbert, z. Jean-Pierre Michel e z. Sebastien Richard.

Duke iu uruar mirëseardhje parlamentarëve francezë, nënkryetari Hamiti i njoftoi ata me historikun e Grupit të Miqësisë Francë-Kosovë në Kuvendin e Kosovës dhe me aktivitetin e tij, si grupi i parë i kësaj natyre i krijuar në Kuvendin e Kosovës. Ai i falënderoi anëtarët e Grupit të Miqësisë për mbështetjen që Asambleja Kombëtare e Francës, krahas Bundestagut gjerman dhe Parlamentit belg, i ka dhënë në vazhdimësi Kuvendit të Kosovës. Hamiti, theksoi, gjithashtu, se në Kosovë ekziston një shoqëri frankofone, e cila përfshin kryesisht njerëz të kulturës dhe shprehu interesim të veçantë që edhe Kosova të futet në grupin e vendeve frankofone.

Kryetarja e Grupit të Miqësisë Francë-Kosovë, Marie-Therese Bruguiere, duke falënderuar për pritjen, theksoi arsyet e vizitës në Kosovë të delegacionit që ajo udhëheq, duke potencuar interesimin për nevojat që ka Kosova dhe ndihmën që mund ta ofrojnë. Parlamentarët francezë u interesuan rreth procesit të integritimit evropian të Kosovës, bashkëpunimit Francë – Kosovë, për përbërjen e Kuvendit të Kosovës, përfaqësimin gjinor e të minoriteteve, ndryshimet e par-



alajmëruara në Kushtetutë dhe Ligj Zgjedhor etj. Hamiti, Kadaj-Bujupi e Hyseni, e informuan delegacionin parlamentar francez për të gjitha çështjet e ngritura, ndërsa theks i veçantë iu kushtua procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën dhe integritimit evropian të saj. Nënkryetari Hamiti, theksoi domosdoshmërinë e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës nëpër vendet e Bashkimit Evropian dhe foli për konsensusin që ekziston në Kosovë rreth aspiratave për anëtarësim në këtë organizatë.

Ishte interesim i dyanshëm që me ftesë të Senatit francez, një delegacion i Kuvendit të Kosovës, në të ardhmen, të vizitojë Francën, në mënyrë që të njihet më për së afërmi me praktikën parlamentare franceze.

Parlamentarët francezë morën përsipër që të angazhohen për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Francës dhe Kosovës edhe në fushën e kulturës.

Kryeparlamentari Krasniqi priti përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve (SHKSH), të kryesuar nga Enver Kurtalani, drejtor ekzekutiv i saj.

Përfaqësuesit e shoqatës, pasi e falënderuan kryetarin Krasniqi për pritjen, shpalosën kërkesat e tyre, të cilat kishin të bënin me përmirësimin e kushteve dhe krijimin e mundësive më të mira për këtë kategori të qytetarëve. Në mënyrë të veçantë, kërkuan që Kuvendi i Kosovës të ketë interpretues të Gjuhës së Shenjave gjatë seancave plenare.

Kryetari Krasniqi shprehu gatishmërinë për t'i ndihmuar personat e shurdhër dhe për të mbështetur çdo iniciativë e cila shërben për përmirësimin e jetës së tyre.

Rreth kërkesës që Kuvendi të ketë interpretues të shenjave gjatë seancave, Krasniqi theksoi se do të bëjë përpjekje që kjo të realizohet, sepse, siç tha ai, edhe personat e shurdhër janë të barabartë me qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.

Kreu i legjislacionit konfirmoi përkushtimin e Kuvendit për t'i dhënë përkrahje këtyre qytetarëve dhe në aspektin e legjislacionit. Në takim u tha se në Kosovë ekzistojnë rreth 15 mijë persona të shurdhër.

Pyetje pa përgjigje

Për zv. Kryeministrin Behgjet Pacolli:

1- Teuta Haxhiu , Deputete e AAK-së

Ju zoti Pacolli keni thënë se nëse vini në pushtet do të reduktoni numrin e ministrive në numër simbolik. A keni ndryshuar bindjen në lidhje me formën e qeverisjes në Kosovë?

2- Donika Kadaj, Deputete e AAK-së

Duke marrë parasysh që prej daljen në skenë si politikan dhe futjes në Qeverinë Thaçi II ju premtuat që falë përvojës suaj në biznes, kryesisht në vendet e ish Bashkimit Sovjetik, Kosovën do ta nxirrni nga kriza e madhe ekonomike, a mund ta artikulonit çka konkretisht do të bëni?

Lutfi Haziri, Deputet I LDK-së

1- Për Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Blerand Stavileci

Çfarë keni ndërmarrë për parandalimin e korrupsionit në subvencione dhe si do të bëni monitorimin apo auditimin e subvencioneve?

2- Për ministrin e Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj

Cilat janë hapat konkrete që keni ndërmarrë për njohjen e Republikës së Kosovës nga 5 shtetet anëtare të BE-së të cilat refuzojnë ta njohin Republikën e Kosovës?

Rita Hajzeraj-Beqaj, Deputete e LDK-së

Për ministrin e Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj

Z. ministër! Prej marrjes së postit të Ministrit të Punëve të Jashtme, sa njohje keni sjellur për shtetin e pavarur të Kosovës, nëse po , cilat janë ato shtete, nëse jo, a e konsideroni se e keni kryer detyrimin tuaj karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës në këtë ministri për këtë çështje?



Ura e Prizrenit



Ura e Rugovës

Trashëgimni Kulturore



Ura e Vushtrrisë

Trashëgimni Kulturore



Ura e Goricës Berat



Kryetari i Kuvendit, pret nje grup nxënësish të gjimnazit “Sami Frasheri” Prishtinë